

RREGULLORJA ZYRTARE E BASKETBOLLIT TE FIBA 2010 INTERPRETIMET ZYRTARE

Interpretimet e paraqitura ne kete dokument jane INTERPRETIMET ZYRTARE TE RREGULLORES TE BASKETBOLLIT TE FIBA 2010 dhe hyjne ne fuqi qe nga 1 tetori 2010 .Kur interpretimet e paraqitura ne kete dokument ndryshojne nga interpretimet e publikuara me pare nga FIBA , ky dokument do te kete perparesi

Rregullorja zyrtare eshte miratuar nga Bordi Qendror i FIBA dhe eshte ndryshuar periodikisht nga Komisioni Teknik i FIBA.

Rregullat jane paraqitur sa me qarte dhe te kuptueshme qe eshte e mundur, por ato shprehin parimet me shume se sa situatat e lojes. Nderkaq, ato nuk mund te mbulojne variantet e shumta te rasteve te veçanta qe mund te ndodhin gjate nje ndeshjeje basketbolli.

Qellimi i ketij dokumenti eshte te konvertoje parimet dhe konceptet e rregullores ne situata praktike dhe te veçanta qe mund te ndodhin ne nje ndeshje normale basketbolli.

Interpretimet e situatave te ndryshme stimulojne mendjet e gjyqtareve dhe plotesojne studimin fillestar te detajuar te rregullores.

Rregullorja Zyrtare e Basketbollit te FIBA mbetet dokumenti kryesor qe drejton basketbollin e FIBA. Nderkaq, gjyqtari i pare ka fuqi dhe autoritet te plote per te marre vendime ne pikat te cilat nuk jane mbuluar posaçerisht ne Rregullore ose ne Interpretimet Zyrtare te FIBA qe pasojne.

ART. 5 DEMTIMI I LOJTAREVE

Rregulli 1 :

Nese nje lojtar eshte demtuar ose duket se eshte demtuar dhe, per kete shkak, treneri, ndihmes treneri, rezerva ose çdo pjestar tjetër i stolit te se njejtës skuader hyn ne fushen e lojes, ky lojtar do te konsiderohet se ka marre mjekim, sido qe aktualisht mund te mos jete mjekuar.

Shembull 1 :

A4 duket se eshte demtuar ne gju dhe ndeshja eshte ndaluar.

(a) Mjeku i skuadres A hyn ne fushe dhe mjekon gjurin e A4-es.

(b) Mjeku i skuadres A hyn ne fushe por A4 eshte tashme gati per loje.

(c) Trajneri A hyn ne fushe per te ndihmuar A4.

(d) Ndhimes trajneri A, rezerva A ose shoqeruesit e skuadres A hyjne ne fushe por nuk trajtojne A4.

Interpretim :

Ne (a), (b), (c) dhe (d) A4 do te konsiderohet se ka marre mjekim dhe duhet te zevendesohet.

Rregull 2

Per te nxjerre nga loja nje lojtar te demtuar seriozisht, nuk do te kete kufizim ne kohe nese sipas mjekut levizja eshte e rrezikshme per lojtarin.

Shembull :

A4 eshte demtuar seriozisht dhe ndeshja eshte ndaluar per rreth 15 minuta sepse doktori keshillon se levizja nga fusha e lojtarit do te jete e demshme per te.

Interpretim :

Opinion i doktorit percakton kohen e pershtatshme per nxjerrjen e lojtarit te demtuar nga fusha. Pas zevendesimit ndeshja do te rifilloje pa ndonje sanksion.

Rregull 3:

Ne qofte se nje lojtar eshte demtuar, ka rrjedhje gjaku ose ka nje plage te hapur, dhe nuk mund te vazhdoje te luaj menjehere (afersisht per 15 sekonda), ai duhet te zevendesohet. Nese eshte marre ndonje pushim nga ndonje skuader ne te njejten periode te topit te ndalur, dhe ky lojtar aftesohet gjate pushimit, ai mund te vazhdoje te luajë vetem ne qoftese sinjali i sekretarit per pushim eshte dhene perpara se nje gjyqtar ne fushe te kete lejuar nje rezerve te behet lojtar.

Shembull :

A4 eshte demtuar dhe ndeshja eshte ndalur. Me qe A4 nuk eshte i afte te luajë menjehere gjyqtari i fryn bilbilit te tij duke bere shenjen perkatese per zevendesim.

Trajneri A (ose trajneri B) kerkon pushim :

- (a) Perpara se zevendesuesi i A4 te kete hyre ne ndeshje.
- (b) Pasi zevendesuesi i A4 te kete hyre ne ndeshje.

Ne mbarim te pushimit, A4 duket se eshte aftesuar dhe kerkon te mbetet ne ndeshje. A do te pranohet kerkesa e A4 ?

Interpretim :

- (a) Pushimi do te jepet dhe nese A4 aftesohet gjate pushimit ai mund te vazhdoje te luaje.
- (b) Pushimi do te jepet por zevendesuesi i A4 tashme ka hyre ne fushe. Nderkaq A4 nuk mund te rihyje deri ne nje mundesi tjeter per zevendesim.

ART. 7 TRAINERET : DETYRAT DHE TE DREJTAT

Rregull 1:

Te pakten 20 minuta perpara orarit te fillimit te ndeshjes secili trainer ose perfaqesuesi i tij do ti paraqese sekretarit nje liste me emrat dhe numrat perkates te anetareve te skuadres te lejuar per te luajtur ne ndeshje.

Traineri eshte personalisht pergjegjes per te siguruar qe numrat ne liste korespondojne me numrat ne bluzat e lojtareve. 10 minuta perpara fillimit te ndeshjes traineri do te konfirmoje emrat dhe numrat korespondues te antareve te skuadres se tij si dhe emrat e trainerit, ndihmes trajnerit dhe kapitenit duke nenshkruar protokollin.

Shembull :

Skuadra A paraqet ne kohe listen e skuadres te sekretari. Numrat e dy lojtareve nuk jane te njejte me numrat ne bluzat e tyre ose emri i lojtarit nuk eshte ne protokoll.

Kjo zbulohet :

- (a) Perpara fillimit te ndeshjes.
- (b) Pas fillimit te ndeshjes.

Interpretim :

- (a) Numrat e gabuar do te korigjohen dhe emri i lojtarit do te shtohet ne protokoll pa ndonje sanksion.
- (b) Gjyqtari do te ndaloje ndeshjen ne nje moment te pershtatshem qe te mos demtoje asnjeren nga skuadrat. Numrat e gabuar do te korigjohen pa ndonje ndeshkim nderkaq, emri i lojtarit nuk do te shtohet ne protokoll.

Rregull 2:

Te pakten 10(dhjete) minuta perpara fillimit te ndeshjes secili trajner do te jape 5(pese) lojtaret qe do te fillojne ndeshjen. Perpara fillimit te ndeshjes sekretari do te kontrolloje nese ka ndonje gabim ne lidhje me keta pese lojtare dhe, nese eshte keshtu, do te njoftoje sa me shpejt te jete e mundur gjyqtarin me te afert. Nese kjo zbulohet perpara fillimit te ndeshjes peseshja e pare korigjohet. Nese kjo zbulohet pasi ka filluar ndeshja ajo nuk merret parasysh.

Shembull:

Eshte zbuluar se ne fushe eshte nje lojtar qe nuk eshte ne peseshen e pare te konfirmuar. Kjo ndodh:

- (a) Perpara fillimit te ndeshjes.
- (b) Pas fillimit te ndeshjes.

Interpretim:

- (a) Lojtari do te zevendesohet pa ndonje denim prej nje lojtari qe ishte konfirmuar ne peseshen e pare.
- (b) Gabimi nuk do te merret parasysh dhe loja do te vazhdoje.

ART. 9 FILLIMI DHE MBARIMI I PERIODES

Rregull 1:

Ndeshja do te filloje nese secila prej skuadrave ka nje minimum prej 5 lojtaresh ne fushe dhe te gatshem per te luajtur. Ne qofte se ne fushe jane me pak se 5 lojtare ne kohen e caktuar per fillimin e ndeshjes, gjyqtaret duhet te jene te arsyeshem per çdo rrethane te paparashikuar qe shkakton vonesen. Ne qofte se paraqitet nje shkak i pranueshem per vonesen, nuk do te jepet gabim teknik. Por, nderkaq, nese ky shkak nuk do te paraqitet, nje gabim teknik dhe/ose humbja aforfe e ndeshjes mund te rezultojte per shkak te mos arrijtes se lojtareve te tjere.

Shembull :

Ne kohen e fillimit te ndeshjes, skuadra A ka me pak se 5 lojtare ne fushe te gatshem per te luajtur.

- (a) Perfaqesuesi i skuadres A paraqet nje shkak te arsyeshem dhe te pranueshem per arritjen vone te lojtareve te skuadres A.
- (b) Perfaqesuesi i skuadres A nuk eshte i afte te paraqese nje shkak te arsyeshem dhe te pranueshem per arritjen vone te lojtareve te skuadres A.

Interpretim :

- (a) Fillimi i ndeshjes do te vonohet ne maksimum per 15 minuta. Nese lojtaret qe mungojne arrijne ne fushe te gatshem per te luajtur perpara se te kene kaluar 15 minuta, ndeshja do te filloje. Nese lojtaret qe mungojne nuk arrijne ne fushe te gatshem per te luajtur para se te kene kaluar 15 minuta ndeshja do ti jepet aforfe skuadres B me rezultatin 20-0.

- (b) Fillimi i ndeshjes do te vonohet ne maksimum per 15 minuta. Nese lojtaret qe mungojne arrijne ne fushe te gatshem per te luajtur para se te kene kaluar 15 minuta, trainerit A i ngarkohet nje gabim teknik (shenuar si 'B') pas te cilit do te filloje ndeshja.

Nese lojtaret qe mungojne nuk arrijne ne fushe te gatshem per te luajtur perpara se te kene kaluar 15 minuta, ndeshja do ti jepet aforfe skuadres B me rezultatin 20-0. Ne te gjitha rastet gjyqtari i pare do shkruaj nje raport ne faqen mbrapa protokolit te ndeshjes per organizatoret e veprimtarise.

Rregull 2 :

Art.9 sqaron cilen shporte mbron nje skuader dhe cilen shporte sulmon ajo skuader. Nese nje periode fillon me te dyja skuadrat qe sulmojne/mbrojne jo ne shportat e duhura, kjo situatë duhet te korigjohet posa ajo zbulohet, pa demtuar ndonjeren prej skuadrave. Te gjitha piket e shenuara, koha qe ka kaluar, gabimet e ngarkuara, etj. perpara ndalimit te ndeshjes do te mbeten te vlefshme.

Shembull 1:

Pas fillimit te ndeshjes gjyqtaret konstatojne se skuadrat jane duke luajtur ne drejtim te gabuar.

Interpretim :

Ndeshja do te ndalohet sa me shpejt qe te jete e mundur dhe pa demtuar ndonjeren prej skuadrave. Skuadrat do te nderrojne shportat. Ndeshja do te filloje ne vendin e kundert ne fushe sa me afer vendit ku ndeshja eshte ndaluar.

Shembull 2 :

Ne fillim te periodes skuadra A eshte duke mbrojtur shporten e vet kur B4 duke humbur orientimin driblon gabimisht drejt shportes se tij dhe shenon nje kosh nga loja.

Interpretim :

2 piket do ti regjistrohen kapitenit te skuadres A qe eshte ne fushen e lojes.

ART. 12 TOPI I HEDHUR DHE ZOTERIMI I ALTERNUAR

Rregull 1:

Skuadra qe nuk zotron topin ne topin e hedhur ne fillim te ndeshjes do te kete te drejten per te rivene topin ne loje ne vendin me te afert ku ndodh situata tjeter e topit te hedhur.

Shembull 1 :

Gjyqtari hedh topin ne topin e hedhur te hapjes se ndeshjes. Menjehere pasi topi preket rregullisht nga kerçyesi A4 :

- (a) Eshte dhene nje top i mbajtur ndermjet A5 dhe B5.
- (b) Eshte dhene nje gabim i dyanshem ndermjet A5 dhe B5

Interpretim:

Per deri sa zoterimi i topit ne fushen e lojes akoma nuk eshte vendosur, gjyqtari nuk mund te perdore shigjeten e zoterimit alternativ per te treguar zoteruesin. Gjyqtari i pare do te beje nje tjeter top te hedhur ne rrethin qendror ku do te kercejne A5 dhe B5. Aq kohe sa ka kaluar ne oren e lojes, nga prekja e rregullt e topit deri ne topin e mbajtur apo ne situaten e gabimit te dyanshem , do te mbetet e konsumuar.

Shembull 2:

Gjyqtari i pare hedh topin per fillimin e ndeshjes, menjehere pasi topi eshte prekur nga kerçyesi A4 ai :

- (a) Del direkt jashte vijave.
- (b) Eshte kapur nga A4 para se ai te preket nga ndonjeri prej 9 lojtareve te tjere ose te preke fushen.

Interpretimi :

Ne te dyja rastet skuadres B i jepet rivenia si rezultat i shkeljes nga A4. Pas rivenies skuadra qe nuk zotron topin ne fushen e lojes do te kete te drejten per zoterimin e pare alternativ nga vendi me i afert me situaten e topit te hedhur qe do te pasojë.

Shembulli 3 :

Skuadra B ka te drejten e rivenies sipas zotrimin te alternuar. Gjyqtari dhe/ose sekretari gabojne dhe topi gabimisht i jepet per rivenie skuadres A.

Interpretim :

Posa topi prek ose preket nga ndonje lojtar ne fushe, gabimi nuk mund te korigjohet. Skuadra B nuk e humbet mundesine e saj te rivenies sipas zotrimin alternativ si pasoje e gabimit dhe do ta kete kete mundesi per situaten tjeter te zotrimin alternativ.

Shembull 4 :

Njekohesisht me sinjalin per perfundimin e pjeses se pare, B5 shkakton nje gabim jospportiv ndaj A5.

Interpretim :

A5 do te gjuaje dy gjuajtje te lira pa lojtare te vendosur gjate zones se gjuajtjeve te lira dhe jashte kohes se lojes. Pas dy minutave te intervalit te lojes, ndeshja do te filloje me rivenie te skuadres A ne zgjatim te vijes se mesit perballe tavolines se gjyqtarise. Asnjera prej skuadrave nuk do te humbase te drejten e saj per rivenien sipas zotrimet alternativ per situaten tjeter te topit te hedhur.

Rregull 2 :

Sa here qe nje top nga loja mbetet midis unazes dhe tabelës, ben perjashtim kur kjo ndodh midis gjuajtjeve te lira, kjo do te jete nje situatë e topit te hedhur qe ka si pasoje rivenien ne loje sipas zoterimit alternativ. Meqenese pas saj nuk kemi luftë ne tabele kjo nuk influencon ne ndeshje ashtu si ndodh pas nje prekje te thjeshte te unazes. Ne qofte se skuadra qe ishte ne zoterim te topit perpara se ai te mbeste midis unazes e tabelës ka te drejten per rivenien, ajo do te kete vetem kohen e mbetur ne aparatën e 24 sekondave si ne çdo situatë tjeter te topit te hedhur.

Shembull 1 :

Ne nje gjuajtje nga loja te A4 topi mbetet midis unazes e tabelës. Skuadra A ka te drejten e rivenies ne loje sipas procedures se zoterimit alternativ.

Interpretim :

Skuadra A do te kete te drejten vetem per kohen e mbetur ne aparatën e 24 sekondave.

Shembull 2 :

Ndersa topi eshte ne ajer ne nje gjuajtje nga loja e A4 mbaron koha e 24 sekondave pas se ciles topi mbetet midis unazes e tabelës. Skuadra A ka te drejten e rivenies ne loje sipas procedures se zoterimit alternativ.

Interpretim :

Meqenese ka mbaruar perioda e 24 sekondave ka ndodhur nje shkelje nga ana e skuadres A. Skuadra B ka te drejten e rivenies ne loje. Skuadra A nuk do te humbasë te drejten e saj per rivenie ne loje ne situaten tjeter te topit te hedhur.

ART 16 KOSHI : KUR SHENOHET DHE VLERA E TIJ

Rregull :

Ne situaten e rivenies ne loje ose ne luftën ne tabele pas gjuajtjes te fundit ose te vetme te lire, kalon nje periudhe kohe qe nga momenti qe nje lojtar brenda ne fushe e prek topin

deri sa ai e gjuan ate per ne shporte. Kjo eshte veçanerisht e rendesishme te kihet parasysh afer mbarimit te nje periode. Duhet te kete nje minimum kohe te pranueshem per nje gjuajtje te tille para se te mbarojë koha e lojes. Ne qofte se ne oren e lojes ka vetem 0 :00 :3 sekonda, eshte detyre e gjyqtarit(gjyqtareve) te vendosin nese gjuajttesi e ka leshuar topin para sinjalit te mbarimit te periodes. Ne qofte se ne oren e lojes ka 0 :00.2 ose 0 :00 .1 sekonda, i vetmi tip i koshit te vlefshem do te jete ai i bere nga nje lojtar ne ajer me prekje direkte ose zhytje te topit.

Shembull :

Skudra A po ve topin ne loje me :

(a) 0 :00.3

(b) 0:00.2 ose 0 :00.1

Te mbetura ne oren e lojes.

Interpretim :

Ne (a), ne qofte se eshte bere nje gjuajtje dhe gjate saj bie sinjali i mbarimit te periodes eshte detyre e gjyqtareve te percaktojne nese topi ishte leshuar perpara se te binte sinjali per perfundimin e periodes.

Ne (b), koshi do te jepet vetem ne qofte se topi qe ishte ne ajer pas rivenies dergohet ne shporte me prekje ose zhytje direkte.

ART. 17 RIVENIA

Rregull 1 :

Ne nje rivenie ne loje, perpara se lojtari te leshoje topin, ndodh qe gjate levizjes duart e lojtarit me top te kalojne planin e ngritur nga vija kufizuese qe ndan pjesen e brendeshme me pjesen e jashteme te hapesires se fushes. Ne situata te tilla, vazhdon pergjegjesia e lojtarit mbrojtës per te evituar nderhyrjen ne rivenien ne loje duke prekur topin ndersa ai eshte akoma ne duart e atij qe ben rivenien.

Shembull :

A4 po ben rivenien ne loje. Ndersa mban topin, duart e A4 kalojne planin e vijes kufizuese keshtu qe topi eshte ne pjesen e brendeshme te hapsires se fushes. B4 rremben topin nga duart e A4 ose godet topin ndersa ai eshte ne duart e A4 pa shkaktuar ndonje kontakt trupor me A4.

Interpretim :

B4 ka nderhyre ne rivenien, duke vonuar fillimin e ndeshjes. B4 do ti terhiqet nje vretje dhe do ti komunikohet dhe trajnerit B. Kjo vretje vlen per te gjithë lojtaret e skuadres B per pjesen e mbetur te lojes. Perseritja e nje veprimi te tille nga ndonje lojtar i skuadres B perben gabim teknik.

Rregull 2 :

Ne rivenien ne loje, lojtari duhet ti pasoje topin (jo dorzoje) shokut te tij brenda fushes se lojes.

Shembull :

Ne nje rivenie nga A4, ky i dorezon topin A5 qe eshte ne fushen e lojes.

Interpretim :

A4 ka bere nje shkelje te rregullit te rivenies. Qe rivenia te jete e rregullt topi duhet te shkeputet nga duart e lojtarit. Topi do ti jepet skuadres B per ta rivene ne loje ne te njejtin vend jashte vijave kufizuese.

Rregull 3 :

Gjate rivenies ne loje lojtaret e tjere nuk duhet te kene ndonje pjese te trupit te tyre tutje vijave kufizuese para se topi te kaloje vijen anesore.

Shembull 1 :

Pas nje shkelje te daljes se topit jashte A3 merr topin prej gjyqtarit per te bere rivenien. A3

- (a) Le topin ne fushe pas se ciles topi merret nga A2.
- (b) I dorezon topin A2 qe eshte jashte vijave kufizuese.

Interpretim :

Kjo eshte nje shkelje e A2 se ai ka levizur trupin e tij tutje vijez kufizuese perpara se topi i hedhur nga A3 te kete kaluar vijen kufizuese.

Shembull 2:

Pas nje koshi nga loja ose nje gjuajtje te lire te sukseshme te skuadres A, skuadres B i eshte dhene nje pushim. Pas pushimit B3 merr topin nga gjyqtari per rivenien ne loje nga vija fundore.

B3

- (a) Vendos topin ne fushe pas se ciles topi merret nga B2.
- (b) I dorezon topin B2 qe gjithashtu eshte pas vijes fundore.

Interpretim :

Loja e rregullt. I vetmi kufizim per skuadren B eshte qe ajo duhet ta pasoje topin ne fushen e lojes brenda 5 sekondave.

Rregull 4:

Nese skuadres qe ka te drejten e zoterimit te topit ne pjesen e prapme te fushes, i jepet nje pushim gjate dy minutave te fundit te periodes se katert ose gjate dy minutave te fundit te çdo kohe shtese, rivenia do te behet ne vijen e rivenies, perballe tavolines se gjyqtarise ne pjesen e perparme te fushes te skuadres qe ben rivenien. Lojtari qe ben rivenien duhet te pasoje topin tek nje shok i skuadres ne pjesen e perparme te fushes .

Shembull 1 :

Ne minuten e fundit te ndeshjes, A4 eshte duke dribluar ne pjesen e prapme, kur nje lojtar i skuadres B e dergon topin jashte ne zgjatim te vijes se gjuajtjeve te lira.

- (a) Skuadres B i jepet nje pushim.
- (b) Skuadres A i jepet nje pushim.
- (c) Ne fillim i jepet nje pushim skuadres B dhe menjehere me pas i jepet pushim skuadres A (ose e kunderta).

Interpretim:

Ne (a), loja do te filloje me rivenie te skuadres A ne zgjatim te vijes se gjuajtjeve te lira. Ne (b) dhe (c) loja do te filloje me rivenie te skuadres A nga vija e rivenies ne loje ne pjesen e perparme te fushes se skuadres A perballe tavolines se gjyqtarise.

Shembull 2 :

Ne minuten e fundit te ndeshjes, A4 po gjuan dy gjuajtje te lira. Gjate gjuajtjes se dyte A4 shkel vijen e gjuajtjeve te lira dhe jepet nje shkelje. Skuadra B kerkon pushim.

Interpretim :

Loja do te filloje me rivenie te skuadres B nga vija e rivenies ne loje ne pjesen e perparme te skuadres B, perballe tavolines se gjyqtarise.

Shembull 3 :

Gjate 2 minutave te fundit te ndeshjes, A4 ka dribluar per 6 sekonda ne pjesen e prapme te fushes, kur :

- (a) B4 e dergon topin jashte.
- (b) B4 ben gabimin e trete te skuadres B ne kete periode.

Skuadres A i jepet nje pushim. Pas pushimit loja do te fillojë me rivenie te skuadres A nga vija e rivenies ne pjesen e perparme te skuadres A, perballe tavolines se gjyqtarise.

Interpretim :

Ne te dy rastet skuadra A ka vetem 18 sekonda te mbetura ne aparatn e 24 sekondave.

Shembull 4 :

Gjate 2 minutave te fundit te ndeshjes, A4 driblon topin ne pjesen e perparme. B3 e dergon topin ne pjesen e prapme te fushes se skuadres A kur nje lojtar i skuadres A fillon ta driblojë topin perseri.

- (a) B4 e dergon topin jashte
- (b) B4 shkakton gabimin e trete te skuadres B ne kete periode

ne pjesen e prapme te skuadres A kur kishin mbetur 6 sekonda ne aparatn e 24 sekondave. Skuadres A i jepet nje pushim. Pas pushimit, loja do te rifillojë me rivenie te A4 nga vija e rivenies ne pjesen e perparme te skuadres A, perballe tavolines se gjyqtarise.

Interpretimi :

Skuadra A do te kete :

- (a) 6 sekonda
- (b) 14 sekonda

te mbetura ne aparatn e 24 sekondave.

Rregull 5 :

Ka disa situata shtese te atyre qe paraqiten ne ART. 17.2.3 ne te cilat rivenia do te behet nga zgjatimi i vijes qendrore, perballe tavolines se gjyqtarise.

Shembull :

- (a) Lojtari duke bere rivenien nga zgjatimi i vijes qendrore perballe tavolines se gjyqtarise ben nje shkelje dhe topi i jepet kundertshtareve per ta vene ne loje ne po te njejtin vend.
- (b) Ne qofte se gjate nje situate rrahjeje pas perjashtimit te antareve te dy skuadrave, nuk ka ndonje denim tjeter per tu administruar, dhe ne kohen qe loja ishte e ndaluar, njera nga skuadrat kishte zoterimin e topit ose kishte te drejten e zoterimit te topit.

Interpretimi :

Ne te dyja rastet lojtari qe ben rivenien mund ta pasojë topin si ne pjesen e perparme ashtu dhe ne pjesen e prapme.

Rregull 6 :

Ne nje rivenie mund te ndodhin situatat e meposhtme :

- (a) Topi eshte pasuar mbi shporten dhe ai preket nga nje lojtar i seciles skuader qe e fut doren ne shporte nga poshte.
- (b) Topi mbetet midis unazes dhe tabeles.
- (c) Topi dergohet me qellim drejt unazes per te rifituar nje periode 24 sekonda.

Shembull 1 :

Ne rivenie A4 pason topin mbi shportë dhe ai preket nga nje lojtar duke futur doren nga poshtë koshit.

Interpretim :

Kjo eshte nje shkelje e nderhyrjes. Loja do te rifillojë me rivenie te kundertshtareve nga zgjatimi i vijes se gjuajtjeve te lira. Ne rastin kur skuadra mbrojtese ben shkeljen, nuk do te shenohen pike per skuadren sulmuese sepse topi nuk eshte derguar nga pjesa e brendëshme e fushes se lojes.

Shembull 2 :

Lojtari A4 qe ben rivenien e pason topin drejt shportes dhe ai mbetet midis unazes dhe tabeles.

Interpretim :

Kjo eshte nje situatë e topit te hedhur. Loja do te rifillojë duke zbatuar proceduren e zoterimit te alternuar. Ne qofte se skuadra A ka te drejten e rivenies ne loje nuk do te rivendoset ne aparat 24 sekonda.

Shembull 3 :

Kur kishte dhe 5 sekonda ne aparatin e 24 sekondave, gjate rivenies ne loje, A4 e pason topin drejt shportes dhe ai prek unazen.

Interpretim :

Mbajtësi i 24 sekondave nuk do të ristartojë aparatit e 24 sekondave sepse nuk ka filluar punën ora e lojës. Loja do të vazhdojë pa ndërprerje.

ART. 18/19 PUSHIMI/ ZEVENDESIMI**Rregull 1 :**

Perpara fillimit të kohës së lojës të një periode ose pas përfundimit të kohës së lojës të një periode nuk jepet pushim.

Zevendesim nuk jepet para fillimit të lojës për periodën e parë ose pasi ka përfunduar koha e lojës së ndeshjes, çdo zevendesim mund të bëhet gjatë intervallave të lojës .

Shembull 1 :

Gjatë topit të hedhur për fillimin e ndeshjes por përpara se topi të jetë prekur rregullisht, kercyesi A5 bën një shkelje dhe topi i kalon skuadrës B për rivenie. Në këtë moment njëri prej trajnerëve kërkon pushim ose zevendesim.

Interpretim :

Pushimi ose zevendesimi nuk do të jepet sepse koha e lojës akoma nuk ka filluar.

Shembull 2 :

Në të njëjtën kohë me sinjalin për përfundimin e një periode ose periode shtesë është dhënë një gabim dhe A4 do të bëjë 2 gjuajtje të lira. Ndonjëri prej trajnerëve kërkon :

- (a) Pushim.
- (b) Zevendesim

Interpretim :

- (a) Pushimi nuk do të jepet sepse ka mbaruar koha e lojës për periodën
- (b) Zevendesimi do të jepet vetëm pas plotësimit të gjuajtjeve të lira dhe ndërkohë që filluar intervali i lojës perioden tjetër ose për perioden shtesë.

Rregull 2 :

Në qoftë se sinjali i aparatit të 24 sekondave bie ndërsa topi është në ajër gjatë një gjuajtjeje nga loja, kjo nuk është shkelje, dhe nuk e ndalon orën e lojës. Në qoftë se gjuajtja nga loja është e sukseshme, kjo është, sipas disa kushteve, mundësi për pushim dhe zevendesim për të dyja skuadrat.

Shembull :

Në një gjuajtje nga loja topi është në ajër kur bie sinjali i 24 sekondave. Topi me pas hyn në shportë. Në këtë kohë :

- (a) Njëra ose të dyja skuadrat kërkojnë zevendesim.
- (b) Njëra ose të dyja skuadrat kërkojnë pushim.

Interpretim :

- (a) Të drejtën për pushim e ka vetëm skuadra që nuk ka shënuar.

Ne qofte se skuadres qe nuk ka shenuar i jepet pushim, pushim mund te marri gjithashtu dhe kundershitari dhe te dyjave skuadrave, nese ato kerkojne, mund ti jepet e drejta e zevendesimit.

(b) Kjo eshte nje mundesi zevendesimi vetem per skuadren qe nuk shenoi dhe vetem ne 2 minutat e fundit te periodes se katert ose 2 minutat e fundit te cdo kohe shtese. Ne qofte se skuadres qe nuk shenoi i eshte dhene zevendesim, dhe kundershitareve gjithashtu mund ti jepet zevendesim, dhe te dyja skuadrave mund ti jepet gjithashtu pushim ne qofte se e kerkojne.

Rregull 3 :

Nese kerkesa per pushim ose zevendesim (per cdo lojtar, perfshire dhe gjuajtesin e gjuajtjeve te lira) eshte bere pasi topi eshte ne dispozicion te gjuajtesit per gjuajtjen e pare ose te vetme te lire, pushimi dhe zevendesimi do te jepet per te dyja skuadrat nese :

- (a) Gjuajtja e fundit ose e vetme e lire perfundon me sukses
- (b) Gjuajtja e fundit ose e vetme e lire do te pasohet nga nje rivenie ne zgjatim te vijes se mesit, perballe tavolines se gjyqtarise ose per cdo arsye kur topi mbetet i ndalur pas gjuajtjes se fundit ose te vetme te lire.

Shembull 1:

A4 i jane dhene 2 gjuajtje te lira. Skuadra A (ose skuadra B) kerkon pushim ose zevendesim:

- (a) Para se topi te jete ne dispozicion te gjuajtesit A4
- (b) Pas gjuajtjes se pare te lire.
- (c) Pas gjuajtjes se dyte dhe te fundit te lire (qe perfundon me sukses) por perpara se topi te jete ne dispozicion te lojtarit qe do te beje rivenien.
- (d) Pas gjuajtjes te dyte dhe te fundit te lire (qe perfundon me sukses) por pasi topi te jete ne dispozicion te lojtarit qe do te beje rivenien.

Interpretim:

- (a) Pushimi ose zevendesimi do te jepen menjehere, perpara gjuajtjes se lire.
- (b) Pushimi ose zevendesimi do te jepen pas gjuajtjes se fundit te lire, nese perfundon me sukses.
- (c) Pushimi ose zevendesimi do te jepen menjehere perpara rivenies.
- (d) Pushimi ose zevendesimi nuk do te jepet.

Shembull 2:

A4 i jane dhene 2 gjuajtje te lira. Pas gjuajtjes se pare eshte kerkuar pushim ose zevendesim nga skuadra A(ose skuadra B). Gjate gjuajtjes se fundit te lire:

- (a) Topi kercen nga unaza dhe ndeshja vazhdon
- (b) Gjuajtja e lire perfundon me sukses.
- (c) Topi nuk prek unazen ose nuk hyn ne shport.
- (d) A4 shkel vijen e gjuajtjeve te lira kur gjuan dhe eshte dhene shkelje.

(e) B4 hyn ne zonen e gjuajtjeve te lira perpara se topi te jete shkeputur nga dora e gjuajtesit A4. B4 i eshte dhene shkelje dhe gjuajtja e lire e A4 nuk ka perfunduar ne shportë.

Interpretim :

- (a) Pushim ose zevendesim nuk jepet.
- (b),(c) dhe (d) Pushimi dhe zevendesimi jepen menjehere.
- (e) A4 do te gjuaje nje gjuajtje te lire shtese dhe , nese perfundon me sukses, pushimi dhe zevendesimi do te jepen menjehere.

Rregull 4:

Nese pas kerkeses per pushim eshte bere ndonje gabim personal nga ndonjera prej skuadrave, perioda e pushimit do te filloje pasi gjyqtari ka perfunduar te gjithë komunikimin me tavolinen ne lidhje me gabimin. Ne rastin e gabimit te 5-te te lojtarit ky komunikim do te perfshije dhe perfundimin e proçedures se nevojshme per zevendesim. Posa te kete perfunduar proçedura per zevendesimin, perioda e pushimit do te filloje kur gjyqtari i fryn bilbilit dhe ben shenjen e pushimit.

Shembull 1 :

Trajneri A ka bere kerkese per pushim, pas së cilës B4 ben gabimin e peste.

Interpretim :

Perioda e pushimit nuk do te filloje para se te perfundoje komunikimi relativ me tavolinen dhe rezerva e B4 te kete hyre ne fushe.

Shembull 2 :

Trajneri A ka bere kerkese per pushim pas se ciles njeri nga lojtaret ka shkaktuar gabim.

Interpretim :

Skuadrat do te lejohen te shkojne tek stolat e skuadres se tyre nese ata jane te sigurt se eshte kerkuar nje pushim, megjithse ky pushim formalisht nuk ka filluar.

Rregull 5 :

Nese gjyqtaret zbulojne se ne fushen e lojes jane njekohesisht me shume se pese lojtare per te njejten skuader, gabimi duhet te korigjohet sa me shpejt qe te jete e mundur pa demtuar kundertshtaret.

Duke menduar se gjyqtaret dhe gjyqtaret e tavolines e kane bere detyren ne rregull, nje lojtar ka hyre ose ka mbetur ne fushe padrejtesisht. Per kete gjyqtaret do te urdherojne nxjerrjen menjehere nga fusha e lojes te nje lojtari dhe trainerit te skuadres do ti ngarkohet nje gabim teknik (regjistruar 'B'). Traineri eshte pergjegjes per zevendesimin dhe per ate qe lojtari i zevendesuar te dale nga fusha menjehere pas zevendesimit.

Shembull :

Kur ka filluar ndeshja zbulohet se skuadra A ka me shume se pese lojtare ne fushe.

- (a) Ne kohen e zbulimit, skuadra B (me pese lojtare) eshte ne zotrim te topit.

(b) Ne kohen e zbulimit, skuadra A (me me shume se pese lojtare) eshte ne zotrim te topit.

Interpretim :

(a) Ndeshja do te ndalohej menjehere, por pa demtuar skuadren B.

(b) Ndeshja duhet te ndalohej menjehere.

Ne te dy rastet lojtari qe ka rihyre (ose ka mbetur) ne loje padrejtesisht, do te largohet nga ndeshja dhe trenerit te skuadres A do ti ngarkohet nje gabim teknik (regjistruar si 'B').

Rregull 6 :

Pasi eshte zbuluar se nje skuader ka me shume se pese lojtare, konstatohet se nga lojtari A5 qe eshte padrejtesisht ne ndeshje, jane shenuar pike ose eshte shkaktuar ndonje gabim personal. Te gjitha keto pike jane te vlefshme dhe çdo gabim i bere nga ai (ose kunder tij) do te njihet si gabim i lojtarit.

Shembull :

Gjyqtaret konstatojne se A5 eshte lojtari i gjashte i skuadres A ne fushen e lojes dhe nderpresin lojen pasi :

(a) Eshte dhene nje gabim ne sulm ndaj A5

(b) Loja eshte ndaluar pas nje koshi nga loja te A5.

(c) Pas nje gabimi te B5 ndaj A5 qe gjuan pa sukses nga loja.

Interpretim :

(a) Gabimi i A5 eshte gabim i lojtarit.

(b) Koshi nga loja i A5 do te njihet.

(c) Gjuajtjet e lira do te behen nga nje lojtar i skuadres A qe eshte ne loje ne kohen kur ndodh gabimi.

Rregull 7:

Art. 18 dhe 19 sqarojne se kur fillon dhe kur mbaron mundesia per te mar pushim ose zevendesim. Trajneret qe desherojne te marin nje pushim ose nje zevendesim duhet ti njohin keto kufizime per ndryshe pushimi ose zevendesimi nuk do te jepen menjehere.

Shembull 1:

Posa ka mbaruar mundesia per nje zevendesim ose pushim, trajneri A vrapon tek sekretari dhe me ze te larte kerkon pushim ose zevendesim. Sekretari reagon dhe gabimisht i bie sinjalit. Gjyqtari i fryn bilbilit dhe nderpret ndeshjen.

Interpretim:

Per shkak te bilbilit te gjyqtarit topi eshte i ndalur dhe koha e lojes mbetet e ndaluar. Si rezultat normalisht eshte mundesia per zevendesim ose pushim. Nderkaq, per arsye se

kerkesa eshte bere me vonese, zevendesimi ose pushimi nuk do te jepen. Loja do te filloje menjehere.

Shembull 2:

Gjate zhvillimit te ndeshjes ndodh nje shkelje e pengimit per shenim ose nderhyrjes mbi topin. Rezervat prej njeres ose te dyjave skuadrave jane duke pritur prane tavolines se gjyqtarise per te hyre ne ndeshje ose eshte kerkuar pushim prej ndonjeres nga skuadrat.

Interpretim:

Shkelja ben qe ora e ndeshjes te ndalohet dhe topi te behet I ndalur. Zevendesimi ose pushimi do te lejohet.

Rregull 8:

Çdo pushim do te zgjasi 1 minute. Skuadrat duhet te kthehen menjehere ne fushen e lojes pasi gjyqtari I fryn bilbilit dhe I fton ato ne fushe. Ndonjehere nje skuader e zgjat pushimin me shume se 1 minute duke perfituar nga zgjatja e pushimit dhe gjithashtu vonon lojen. Nga ana e gjyqtarit kesaj skuadre do I jepet nje verejtje. Ne qofte se skuadra nuk I pergjigjet verejtjes asaj do ti ngarkohet nje pushim shtese. Ne qofte se skuadres nuk I ka mbetur me pushim, nje gabim teknik per vonese te ndeshjes do ti ngarkohet trajnerit, shenuar si 'C'.

Shembull :

Perioda e pushimit ka mbaruar dhe gjyqtari fton skuadren A te kthehet ne fushen e lojes. Trajneri A vazhdon te udhezojë skuadren e tij duke mbetur ne hapesiren e stolit te skuadres. Gjyqtari e ri fton skuadren A ne fushen e lojes dhe

- (a) Skuadra A me ne fund vjen ne fushen e lojes
- (b) Skuadra A vazhdon te mbetet ne hapesiren e stolit te skuadres

Interpretim

- (a) Pasi skuadra fillon te kthehet ne fushe, gjyqtari I ben nje verejtje trajnerit se nese nje sjellje e tille do te perseritet ndaj skuadres A do te jepet nje pushim shtese.
- (b) Nje pushim, pa paralajmerim do ti jepet skuadres A, ne qofte se skuadra A nuk ka me pushime ndaj trajnerit A do te jepet nje gabim teknik per vonese te ndeshjes qe shenohet si 'C'.

ART.24 DRIBLIMI

Rregull :

Ne qofte se nje lojtar me dashje e hedh topin ne tabele (jo per nje gjuajtje nga loja) kjo do te konsiderohet njelloj sikur lojtari te perplaste topin ne toke. Nese lojtari e prek topin perseri perpara se ai te preke (ose te preket nga) nje lojtar tjetër do te konsiderohet nje lloj si driblim.

Shembull 1 :

A4 nuk ka dribluar akoma kur ai e hedh topin ndaj tabelës dhe e kap ate perseri perpara se topi te kete prekur nje lojtar tjetër.

Interpretim :

Pas kapjes se topit A4 mund te gjuaje ose te pasoje por nuk mund te filloje nje driblim te ri.

Shembull 2 :

Pas perfundimit te nje driblimi, qofte ne levizje te vazhdueshme ose duke qene ne vend, A4 tashti e hedh topin ndaj tabelës dhe e kap ose e prek ate perseri para se ai te preket nga nje lojtar tjetër.

Interpretim :

A4 ka shkaktuar shkeljen e nje driblimi te dyfishtë.

ART. 25 ECJA ME TOP**Rregull**

Eshte e lejueshme qe nje lojtar qe eshte i shtrire ne fushe të hyjë ne zoterim te topit. Eshte e lejueshme qe nje lojtar duke mbajtur topin bjere ne fushe. Eshte gjithashtu e lejueshme qe nje lojtar pas renies ne fushe te rreshqase . Sidoqofte lojtari ben shkelje nese me pas rrokulliset ose tenton te ngrihet ne kembe ndersa eshte duke mbajtur topin.

Shembull 1:

A3, ndersa mban topin, humbet ekuilibrin dhe bie ne fushe.

Interpretim :

Veprimi i renies ne fushe pa dashje i A3 eshte i rregullt.

Shembull 2 :

A3, duke qene i shtrire ne fushe, hyn ne zotrim te topit. Me pas A3

- (a) Pason topin tek A4.
- (b) Fillon driblimin duke qene i shtrire.
- (c) Tenton te ngrihet duke mbajtur topin.

Interpretim :

Ne (a) dhe (b), veprimi i A3 eshte i rregullt.

Ne (c), ka ndodhur nje shkelje e rregullit te ecjes me top.

Shembull 3 :

A3, duke mbajtur topin, bie ne toke dhe momentalisht rreshqet .

Interpretim :

Veprimi i rreshqitjes pa dashje te A3 nuk perben shkelje. Nderkaq, nese A3, duke mbajtur topin, rrokulliset ose tenton te ngrihet shkel rregullin.

ART.28 TETE SEKONDA

Rregull 1 :

Zbatimi i ketij rregulli bazohet vetem ne numurimin individual te 8 sekondave nga nje gjyqtar. Ne rast te ndonje mosperputhjeje midis numurit te sekondave te numuruara nga gjyqtari dhe atyre te shfaqura ne aparatit e 24 sekondave, do te kete precedence vendimi i gjyqtarit.

Shembull :

A4 eshte duke dribluar topin ne pjesen e prapme kur gjyqtari jep nje shkelje te 8 sekondave. Display ne aparatit e 24 sekondave tregon se kane kaluar vetem 7 sekonda.

Interpretim :

Vendimi i gjyqtarit eshte i rregullt. Gjyqtari eshte i vetmi pergjegjes qe vendos kur ka perfunduar perioda e 8 sekondave.

Rregull 2:

Nese numrimi i 8 sekondave ne pjesen e prapme ndalohet per shkak te nje situate te topit te hedhur dhe rivenia sipas zoterimit alternativ eshte per skuadren qe ishte ne zoterim te topit, kjo skuader do te kete vetem aq kohe sa ka mbetur ne perioden e 8 sekondave.

Shembull :

Skuadra A ishte ne kontroll te topit per 5 sekonda ne pjesen e prapme te fushes kur ndodh nje top i mbajtur. Skuadra A ka te drejten e rivenies sipas zoterimit alternativ.

Interpretim :

Skuadra A do te kete vetem 3 sekonda per ta çuar topin ne pjesen e perparme te fushes se skuadres A.

Rregull 3

Gjate driblimit nga pjesa e prapme ne pjesen e perparme te fushes se skuadres, topi shkon ne pjesen e perparme te fushes se skuadres kur te dy kembet e dribluesit dhe topi jane ne kontakt me pjesen e perparme te fushes.

Shembull 1 :

A1 qendron ne fushe duke pasur ndermjet kembeve vijen e mesit. Ai merr nje top nga A2 qe eshte ne pjesen e prapme. Me pas A1 e pason tek A2 qe vazhdon te jete ne pjesen e prapme.

Interpretim :

Loje e rregullt. A1 nuk i ka te dy kembet ne pjesen e perparme keshtu qe ai mund ta pasojë topin ne pjesen e prapme. Numurimi i tete sekondave do te vazhdoje.

Shembull 2 :

A2 driblon topin nga pjesa e prapme dhe e mbaron driblimin duke pasur vijen e mesit ndermjet kembeve ndersa mban topin. Pas kesaj A2 i pason topin A1 i cili gjithashtu ndodhet ne fushe duke pasur vijen e mesit ndermjet kembeve.

Interpretim :

Loje e rregullt. A2 nuk i ka te dy kembet ne pjesen e perparme dhe keshtu qe ai mund te pasoje topin tek A1 i cili gjithashtu nuk eshte ne pjesen e perparme. Numurimi i tete sekondave do te vazhdoje.

Shembull 3 :

A2 eshte duke dribluar topin nga pjesa e prapme e fushes dhe ka nje kembe (jo te dyja kembet) ne pjesen e perparme te fushes. Me pas ai i pason topin A1, qe eshte i vendosur duke pasur vijen e mesit ndermjet kembeve. A1 me pas vazhdon driblimin ne pjesen e prapme te fushes.

Interpretim :

Loje e rregullt. A2 nuk i ka te dy kembet ne pjesen e perparme dhe keshtu qe ai mund te pasoje topin tek A1 i cili gjithashtu nuk eshte ne pjesen e perparme. A1 lejohet te driblojë topin ne pjesen e prapme te fushes. Numurimi i tete sekondave do te vazhdoje.

Shembull 4:

A4 eshte duke dribluar topin nga pjesa e prapme e fushes kur ai ndalon levizjen e tij duke dribluar :

- (a) Ndersa ka vijen e mesit ndermjet kembeve.
- (b) Ndersa te dy kembet i ka ne pjesen e perparme por topin e driblon ne pjesen e prapme.
- (c) Ndersa te dy kembet i ka ne pjesen e prapme por topin e driblon ne pjesen e perparme.
- (d) Ndersa te dy kembet i ka ne pjesen e perparme ndersa driblon topin ne pjesen e prapme, pas kesaj A4 kthehet me te dy kembet ne pjesen e prapme.

Interpretim :

Ne te gjitha rastet dribluesi A4 vazhdon te jete ne pjesen e prapme derisa te dy kembet dhe topi te prekin pjesen e perparme te fushes. Numurimi i 8 sekondave do te vazhdoje ne te gjitha situatat.

ART.29 NJEZET E KATER SEKONDA

Rregull 1 :

Nje gjuajtje nga loja eshte bere afer mbarimit te periodes se 24 sekondave dhe sinjali bie kur topi eshte ne ajer. Nese topi nuk prek unazen, ka ndodhur nje shkelje me perjashtim kur kundertshtaret kane fituar kontrollin e menjehershem te topit. Topi do ti jepet

kundershtareve per rivenien ne loje nga vendi me i afert ku ndeshja eshte nderprere nga gjyqtari, por jo direkt prapa tabelës.

Shembull 1 :

Gjate gjuajtjes te A5 topi eshte ne ajer kur bie sinjali i aparatit te 24 sekondave. Topi prek tabelen dhe pastaj rrokulliset ne fushe ku preket nga B4 pastaj nga A4 dhe ne fund kontrollohet nga B5.

Interpretim :

Kjo eshte nje shkelje e 24 sekondave sepse topi nuk ka prekur unazen dhe me pas nuk kemi nje kontroll te topit te menjehershëm dhe te qarte nga kundershtaret.

Shembull 2 :

Ne nje gjuajtje te A5 topi prek tabelen, por nuk arrin unazen. Ne luften ne tabele, topi preket por nuk kontrollohet nga B5, pas kesaj A5 hyn ne zoterim te topit. Ne kete kohe bie sinjali i aparatit te 24 sekondave.

Interpretim :

Ka ndodhur nje shkelje e 24 sekondave. Aparati i 24 sekondave vazhdon te punoje kur topi nuk godet unazen dhe ai kontrollohet perseri nga nje lojtar i skuadres A.

Shembull 3 :

Ne mbarim te periodes se 24 sekondave, A4 gjuan ne shporte. Topi eshte bllokuar rregullisht nga B4 dhe pastaj bie sinjali i aparatit te 24 sekondave. Pas sinjalit B4 ben gabim ndaj A4.

Interpretim :

Ka ndodhur nje shkelje e 24 sekondave. Gabimi i B4 nuk do te merret parasysh me perjashtim kur ai eshte gabim teknik, gabim josportiv ose gabim perjashtimi.

Shembull 4 :

Topi eshte ne ajer ne nje gjuajtje te A4 kur bie sinjali i aparatit te 24 sekondave. Topi nuk arrin unazen, pas kesaj menjehere jepet nje top i mbajtur ndermjet A5 dhe B5.

Interpretim:

Ka ndodhur nje shkelje e 24 sekondave. Skuadra B nuk ka hyre menjehere dhe qarte ne zoterim te topit.

Rregull 2 :

Ne qofte se sinjali i 24 sekondave bie ne nje suate kur, sipas mendimit te gjyqtareve, kundershtaret kane hyre menjehere dhe qarte ne kontroll te topit sinjali nuk do te perfillet dhe ndeshja do te vazhdoje.

Shembull :

Afer mbarimit te periodes se 24 sekondave pasimi i A4 nuk eshte zoteruar nga A5 (te dy lojtaret jane ne pjesen e perparme) dhe topi rrokulliset ne pjesen e prapme te fushes se skuadres A. Perpara se B4 te hyjë ne zoterim te topit duke e pasur te lire rrugen drejt koshit bie sinjali I 24 sekondave.

Interpretim:

Ne qofte se B4 hyn ne kontroll te topit menjehere dhe qarte sinjali nuk do te perfillet dhe ndeshja do te vazhdoje.

Rregull 3 :

Nese skuadres qe ishte ne kontroll te topit i eshte dhene nje rivenie sipas zoterimit alternativ, kjo skuader do te kete aq kohe sa ka mbetur ne perioden e 24 sekondave nga koha kur ka ndodhur situata e topit te hedhur.

Shembull 1 :

Skuadra A eshte ne zoterim te topit me 10 sekonda te mbetura ne perioden e 24 sekondave kur jepet nje top i mbajtur. Rivenia sipas zoterimit alternativ ishte per :

- (a) Skuadren A
- (b) Skuadren B

Interpretim:

- (a) Skuadra A do te kete vetem 10 sekonda ne perioden e 24 sekondave.
- (b) Skuadra B do te kete nje periode te re 24 sekonda.

Shembull 2 :

Skuadra A eshte ne zoterim te topit me 10 sekonda te mbetura ne perioden e 24 sekondave kur topi del jashtë fushes. Gjyqtaret nuk bein dakord se cila skuadër A ose B e ka prekur e fundit topin para se ai te dilte jashte. Eshte dhene nje situatë e topit te hedhur dhe rivenia sipas zoterimit alternativ eshte per:

- (a) Skuadren A
- (b) Skuadren B

Interpretimi:

- (a) Skuadra A do te kete vetem 10 sekonda te mbetura ne aparat in e 24 sekondave.
- (b) Skuadra B do te kete nje periode te re 24 sekonda.

Rregull 4 :

Nese ndeshja eshte ndaluar nga nje gjyqtar per nje gabim ose shkelje (por jo per daljen e topit jashte) te bere nga nje skuader qe nuk eshte kontroll te topit dhe zoterimi topit do ti jepet te njejtes skuader qe ishte ne kontroll te topit ne pjesen e perparme, aparati i 24 sekondave do te rivendoset si me poshte :

- Nese ne kohen qe ndalohet loja ne aparat in e 24 sekondave jane 14 ose me shume sekonda, nuk do te vendoset ne aparat nje periode e re e 24 sekondave por do te vazhdoje qe nga koha qe ajo ishte ndaluar.
- Nese ne kohen qe ndalohet loja ne aparat in e 24 sekondave jane 13 ose me pak sekonda, ne aparat do te vendosen 14 sekonda.

Shembull 1 :

B4 ben nje shkelje te nxjerrjes se topit jashte ne pjesen e perparme te te skuadres A. Ne displayin e 24 sekondave jane 8 sekonda.

Interpretim :

Skuadra A do te kete vetem 8 sekonda per te mbaruar sulmin.

Shembull 2 :

A4 driblon topin ne pjesen e perparme dhe ndaj tije B4 shkakton nje gabim. Ky ishte gabimi i dyte i skuadres B ne kete periode. Display i 24 sekondave tregon 3 sekonda.

Interpretim :

Skuadra A do te kete 14 sekonda per te perfunduar sulmin.

Shembull 3 :

Kur kishte dhe 4 sekonda te mbetura ne displayin e 24 sekondave ,skuadra A eshte ne kontroll te topit ne pjesen e perparme :

- (a) A4
- (b) B4

Eshte demtuar dhe gjyqtaret nderpresin ndeshjen.

Interpretim :

Skuadra A do te kete :

- (a) 4 sekonda
- (b) 14 sekonda

Per te perfunduar sulmin.

Shembull 4 :

A4 leshon topin per nje gjuajtje nga loja . Ndersa topi eshte ne ajer jepet nje gabim i dyanshem ndaj A5 dhe B5 ndersa ne displayin e 24 sekondave kishin mbetur vetem 6 sekonda. Topi nuk hyn ne shporte.Shigjeta e zoterimit alternativ tregon zoterimin per skuadren A.

Interpretim :

Skuadra A do te kete te drejten e 6 sekondave per te perfunduar sulmin.

Shembull 5 :

Kur kishte dhe 5 sekonda te mbetura ne displayin e 24 sekondave, A4 ishte duke dribluar ndersa ndaj B4 eshte dhene nje gabim teknik pasuar nga nje gabim teknik ndaj trajnerit A.

Interpretim :

Pas anulimit te denimeve te njellojta, ndeshja do te filloje me rivenie ne loje per skuadren A me 5 sekonda te mbetura ne displayin e 24 sekondave.

Shembull 6 :

Me :

- (a) 16 sekonda
- (b) 12 sekonda

Te mbetura ne displayin e 24 sekondave, B4 ne pjesen e prapme te fushes shkelmon me qellim ose godet me grusht topin.

Interpretim :

Kemi shkelje nga skuadra B. Pas rivenies ne loje ne pjesen e perparme skuadra A do te kete :

- (a) 16 sekonda
- (b) 14 sekonda

Te mbetura ne displayin e 24 sekondave.

Shembull 7 :

Gjate nje rivenie ne loje te A2, B4 ne pjesen e prapme zgjate krahut tutje vijes kufizuese dhe bllokun pasimin e A's kur ne displayin e 24 sekondave kishin mbetur :

- (a) 19 sekonda
- (b) 11 sekonda

Interpretim :

Kemi shkelje te B4 pas rivenies ne pjesen e perparme skuadra A do te kete :

- (a) 19 sekonda
- (b) 14 sekonda

Te mbetura ne displayin e 24 sekondave.

Shembull 8 :

A4 driblon topin ne pjesen e perparme kur B4 ben nje gabim jo sportiv mbi A4. Ne displayin e 24 sekondave kishin mbetur 6 sekonda.

Interpretim :

Pavaresisht nga rezultati i gjuatjeve te lira, skuadra A ka te drejten e rivenies ne zgjatim te vijes se mesit perballe tavolines se gjyqtarise. Skuadra A do te kete nje periudhe te re 24 sekonda.

I njejt interpretim eshte i vlefshem per gabimin teknik dhe gabimin e perjashtimit.

Rregull 5 :

Ne qofte se loja ngalohet nga nje gjyqtar per ndonje arsye qe nuk ka lidhje me njerin nga skuadrat dhe nese sipas gjykimit te gjyqtareve, kundersharet jane vene ne disavantazh, perioda e 24 sekondave do te vazhdoje qe nga koha qe ajo eshte ndalur.

Shumbull 1 :

Me 0 :25 sekonda ne minutin e fundit te ndeshjes me rezultatin A 72- B 72 skuadra A hyn ne zoterim te topit dhe e driblon ate per 20 sekonda kur ndeshja ndalohet nga gjyqtaret sepse :

- (a) Ora e lojes ose aparati i 24 sekondave ndalon ose nuk fillon
- (b) Ne fushen e lojes eshte hedhur nje shishe
- (c) Ne display jane vendosur gabimisht 24 sekonda.

Interpretim :

Ne te gjitha rastet ndeshja do te rifilloje me rivenie te skuadres A me 4 sekonda te mbetura ne displayn e aparatit te 24 sekondave. Skuadra B do te vihej ne disavantazh ne qoftese ndeshja do te fillonte me nje periode te re prej 24 sekondash.

Shembull 2 :

Pas gjuajtjes nga loja te A3 topi godet unazen dhe me pas kontrollohet nga A5. 9 sekonda me vone gabimisht bie sinjali i aparatit te 24 sekondave. Gjyqtaret ndepresin ndeshjen.

Interpretim :

Skuadra A ne kontroll te topit do te vihej ne disavantazh nese do te jepej nje shkelje e 24 sekondave. Pas keshillimit me vezhguesin dhe mbajtesin e 24 sekondave gjyqtaret e fillojne ndeshjen me rivenie per skuadren A me 15 sekonda te mbetura ne displayn e 24 sekondave.

ART. 30 TOPI I KTHYER NE PJESEN E PRAPME

Rregull :

Ne nje kercim, lojtari qe eshte ne ajer ruan te njejtin status ne lidhje me fushen si e kishte para se te kercente ne ajer. Nderkaq, kur lojtari qe eshte ne ajer kercent nga pjesa e perparme dhe hyn ne zoterim te topit duke qene ne ajer, ai eshte lojtari i pare i skuadres qe vendos zoterimin e topit nga skuadra.

Ne qofte se ne kete moment ai kthehet ne pjesen e prapme te fushes ai e ka te pamundur te evitojë kthimin e topit prapa. Keshtu qe nese nje lojtare ne ajer vendos nje zoterim te ri te topit nga skuadra, pozicjoni relativ i tij ne lidhje me pjesen e perparme/prapme do te percaktohet aty ku ai bie me te dyja kembet ne fushe.

Shembull 1 :

A4 ne pjesen e prapme te fushes tenton nje pasim te gjate tek A5 ne pjesen e perparme te fushes. B3, kercent nga pjesa e perparme e fushes se skuadres B, kap topin duke qene ne ajer dhe bie :

- (a) Me te dy kembet ne pjesen e prapme te B.
- (b) Duke pasur ndermjet kembeve vijen e mesit.
- (c) Duke pasur ne mes te kembeve vijen e mesit dhe me pas driblon ose pason topin ne pjesen e prapme.

Interpretim

Nuk ka ndodhur ndonje shkelje. B3 eshte i pari lojtar qe duke qene ne ajer vendos kontrollin e topit nga ana e skuadres B. Pozicioni i tij relativ ne lidhje me pjesen e

perparme/prapme te fushes nuk eshte percaktuar derisa B3 te kthehet me te dy kembet ne fushe. Ne te gjitha rastet B3 konsiderohet rregullisht ne pjesen e prapme.

Shembull 2 :

Ne topin e hedhur per fillimin e periodes se pare midis A4 dhe B4, topi eshte prekur rregullisht kur A5 kercen qe nga pjesa e perparme , kap topi duke qene ne ajer dhe bie

- (a) Me te dy kembet ne pjesen e prapme.
- (b) Duke pasur ndermjet kembeve vijen e mesit.
- (c) Duke pasur vijen e mesit midis kembeve dhe pastaj driblon ose pason topin ne pjesen e prapme.

Interpretim :

Nuk ka ndodhur ndonje shkelje. A5 vendos kontrollin e pare te topit per skuadra A duke qene ne ajer. Ne tegjitha rastet A5 eshte rregullisht ne pjesen e prapme.

Shembull 3 :

Lojtari A4 po ben nje rivenie ne loje ne pjesen e perparme te fushes se skuadres A dhe tenton te pasoje topin tek A3. A3 kercen nga pjesa e prapme ,duke qene ne ajer kap topi dhe bie :

- (a) Me te dy kembet ne pjesen e prapme.
- (b) Duke pasur ndermjet kembeve vijen e mesit.
- (c) Duke pasur vijen e mesit midis kembeve dhe pastaj driblon ose pason topin ne pjesen e prapme.

Interpretim :

Skuadra A ka bere shkelje. A4 qe ben rivenien ka vendosur kontrollin e topit per skuadren A ne pjesen e perparme para se A3 te kapte topin duke qene ne ajer dhe te binte ne pjesen e prapme. Ne te gjitha rastet A3 ka bere shkelje te kthimit te topit prapa.

Shembull 4 :

A4 nga pjesa e prapme tenton nje pasim te A5 ne pjesen e perparme. B4 kercen nga pjesa e perparme, kap topin duke qene ne ajer dhe perpara se te bjere ne pjesen e prapme te fushes e pason topin te B5 qe eshte ne pjesen e prapme.

Interpretim :

Skuadra B ka bere shkelje te kthimit te topit ne pjesen e prapme.

ART.31 PENGIMI PER SHENIM DHE NDERHYRJA MBI TOPIN

Rregull 1 :

Kur topi eshte mbi unazen ne nje gjuajtje nga loja ose ne nje gjuajtje te lire, eshte nderhyrje nese nje lojtar fut doren nga poshte koshit dhe prek topin.

Shembull:

Ne gjuajtjen e fundit ose te vetme te lire nga A4 :

(a) Para se topi te preke unazen.

(b) Pasi topi ka prekur unazen dhe akoma ka mundesi te hyjë ne shporte, B4 fut doren nga poshte koshit dhe prek topin.

Interpretim :

Ka ndodhur nje shkelje nga B4 per prekjen e topit ne menyre te parregullt.

(a) A4 do ti jepet nje pike dhe B4 do te denohet me gabim teknik.

(b) A4 do ti jepet nje pike por B4 nuk do te denohet me gabim teknik.

Rregull 2 :

Kur topi eshte mbi unaze gjate nje pasimi ose pasi ai ka prekur unazen, eshte nderhyrje ne qofte se nje lojtar fut doren nga poshte shportes dhe prek topin.

Shembull:

Topi eshte mbi unaze si rezultat i nje pasi kur B4 duke futur doren nga poshte koshit prek topin.

Interpretim :

Shkelje nga B4. Skuadres A do ti jepen dy ose tre pike.

Rregull 3 :

Pas gjuajtjes se fundit ose te vetme te lire dhe pasi topi ka prekur unazen, gjuajtja e lire ndryshon statusin dhe behet gjuajtje per dy pike nga loja nese topi preket rregullisht nga ndonje lojtar para se te hyje ne shporte.

Shembull :

Ne gjuajtjen e fundit ose te vetme te lire te A4 topi prek unazen dhe gjate kercimit te tij siper saj B4 ne perpjekje per ta larguar topin e dergon ne shporte.

Interpretim :

Meqenese topi eshte prekur rregullisht, gjuajtja e lire ka ndryshuar statusin dhe skuadres A do ti jepen dy pike.

Rregull 4 :

Nese pas nje gjuajtje nga loja, nje lojtar prek topin kur ai eshte gjate ngjitjes , do te zbatohen te gjitha kufizimet qe kane te bejne me pengimin per shenim dhe nderhyrjen mbi topin.

Shembull :

Ne nje gjuajtje nga loja te A4, topi eshte ne ajer kur ai preket gjate ngjitjes nga B5 (ose A5). Gjate renies se tij per ne kosh ai preket :

- (a) Nga A3
- (b) Nga B3

Interpretim :

Prekja e A5 (ose B5) kur topi eshte ne ngjitje eshte e rregullt dhe nuk e ndryshon statusin e gjuajtjes nga loja. Ndersa, prekjet e tjera kur topi eshte gjate renies te A3 ose B3 jane shkelje. Ne:

- (a) Topi do ti jepet skuadres B per rivenie ne loje nga zgjatimi i vijes se gjuajtjeve te lira.
- (b) Skuadres A do ti jepen dy ose tre pike.

Rregull 5 :

Do te konsiderohet nderhyrje nese gjate nje gjuajtje nga loja, nje lojtar lekund tabelen ose unazen ne menyre qe topi , sipas gjykimit te gjyqtarit, eshte penguar per te hyre ne shporte ose eshte ndihmuar te hyj ne shporte.

Shembull:

A4 gjuan per tre pike afer mbarimit te ndeshjes. Ndersa topi eshte ne ajer bie sinjali i mbarimit te ndeshjes. Pas sinjalit, B4 lekund unazen ose tabelen dhe per shkak te ketij veprimi, sipas gjykimit te gjyqtarit, topi pengohet per te hyre ne shporte.

Interpretim :

Edhe pse ka rene sinjali per mbarimin e ndeshjes, topi mbetet ne loje dhe keshtu ka ndodhur shkelja e nderhyrjes. Skuadres A do ti jepen tre pike.

Rregull 6 :

Gjate nje gjuajtje nga loja kemi nderhyrje nga nje lojtar mbrojtës ose sulmues kur lojtari prek shportën ose tabelen ndersa topi eshte ne takim me unazen dhe ka akoma mundesi te hyje ne shporte.

Shembull :

Pas nje gjuajtje nga loja te A4, topi kercen nga unaza dhe bie perseri mbi te. Topi eshte akoma ne takim me unazen kur B4 prek shportën ose tabelen.

Interpretim :

Shkelje nga B4. Kufizimet e nderhyrjes zbatohen deri sa eshte mundesia qe topi te hyje ne shporte.

ART. 35 GABIMI I DYANSHEM

Rregull :

Sa here qe per ndonje thyerje te rregullave te cilat ndodhin afersisht ne te njejten kohe, ka vendime kontradiktore nga gjyqtaret dhe nje nga sanksionet eshte anullimi i nje koshi te shenuar, ky sanksion merr perparsi dhe nuk do te njihen piket.

Shembull :

Gjate nje akti gjuajtjeje kemi nje kontakt fizik ndermjet gjuajtesit A4 dhe B4. Topi hyn ne shporte. Gjyqtari prijes jep gabim ne sulm ndaj A4 dhe keshtu duhet te anulohet koshi. Gjyqtari ndjekes jep gabim ne mbrojtje ndaj B4 dhe keshtu koshi duhet te njihet.

Interpretim :

Ky eshte nje gabim i dyanshem dhe koshi nuk do te jete i vlefshem. Loja do te rifilloje me rivenie nga ana e skuadres A ne zgjatim te vijes se gjuajtjeve te lira. Skuadra do te kete vetem aq sekonda sa kane mbetur ne perioden e 24 sekondave ne momentin e dhenies se gabimit te dyanshem.

ART.33 Kontakti: PARIMET E PERGJITHESHME**33.10 Zonat gjysme rrethore pa ndeshje****Rregull**

Qellimi I rregullit te 'gjysme rrethit pa ndeshje' eshte qe te mos favorizojte nje lojtar mbrojtjes qe ze nje pozicion nen koshin e tij per te perfituar nje gabim ndeshjeje ndaj nje lojtari sulmues qe eshte ne zoterim te topit dhe po penetron drejt shportes.

Qe te zbatohet rregulli I 'gjysem rrethit pa ndeshje':

- (a) Lojtari mbrojtjes duhet ti kete te dyja kembet brenda zones gjysem rrethore (shiko Diagram 1). Vija e gjysem rrethit nuk eshte pjese e zones gjysem rrethore.
- (b) Lojtari sulmues duhet ti drejtohet shportes nepermjet vijes gjysem rrethore dhe te perpiqet per te gjuajtur nga loja ose per te pasuar kur eshte ne ajer.

Rregulli I 'gjysme rrethit pa ndeshje' nuk do zbatohet dhe çdo kontakt do te gjykohet sipas rregullave normale, psh; parimi I cilindrit, parimi ndeshje-blok:

- (a) Per te gjitha situatat e lojes qe ndodhin jashte zones se gjysem rrethit pa ndeshje, gjithashtu per situatat qe zhvillohen ne hapësirën midis zones se gjysem rrethit dhe vijes fundore.
- (b) Per situatat e luftes ne tabele(rebound) kur, pas nje gjuajtje nga loja topi kthehet nga tabela dhe ndodh nje situatë kontakti.
- (c) Per çdo perdorim te palejuar te duarve , kraheve, kembeve ose trupit te çdo lojtari mbrojtjes ose sulmues qofte.

Shembull 1:

A4 tenton nje gjuajtje me kercim qe fillon jashte zones se gjysem rrethit dhe ndesh B4 qe eshte brenda zones se gjysem rrethit.

Interpretim :

Aksioni I A4 eshte I lejueshem.Eshte zbatuar rregulli I gjysem rrethit pa ndeshje.

Shembull 2:

A4 driblon topin gjate vijes fundore dhe, pasi ka arritur ne hapsiren prapa tabelës, kercen diagonal ose mbrapsht dhe ndesh B4 qe eshte ne pozicion te rregullt mbrojtës brenda zones se gjysme rrethit.

Interpretim:

Gabim ndeshjeje I A4. Rregulli I gjysme rrethit pa ndeshje nuk zbatohet sepse A4 ka hyrë ne zonen gjysem rrethore pa ndeshje nga fusha e lojës direkt pas tabelës dhe zgjatimit te vijes imagjinare (shiko Diagramin 1)

Shembull 3:

Topi I nje gjuajtjeje nga loja te A4 takon unazen dhe ndodh nje situatë rebaundi. A5 kercen ne ajër, kap topin dhe me pas bie mbi B4 qe eshte ne pozicion te rregullt mbrojtës brenda zones se gjysem rrethit.

Interpretim:

Gabim ndeshjeje I A5. Rregulli I gjysme rrethit pa ndeshje nuk zbatohet.

Shembull 4:

A4 I drejtohet koshit dhe eshte ne aktin e gjuajtjes. Ne vend qe te perfundoje gjuajtjen A4 pason topin te A5 qe eshte pas tij. Me pas A4 bie mbi B4 qe eshte brenda zones gjysme rrethore pa ndeshje. Keshtu qe A5 me top ne dorë e ka te hapur rugen per te shenuar ne kosh .

Interpretim:

Gabim ndeshjeje I A4. Rregulli I gjysem rrethit pa ndeshje nuk zbatohet sepse A4 padrejtesisht perdor trupin e tij per te hapur rugen drejt koshin per A5.

Shembull 5:

A4 I drejtohet koshit dhe eshte ne aktin e gjuajtjes. Ne vend qe te perfundojë gjuajtjen A4 pason topin te A5 qe eshte ne qoshen e fushës se lojës. A4 me pas bie mbi B4 qe eshte brenda zones se gjysme rrethit.

Interpretim:

Aksioni I A4 eshte I rregullt. Ketu zbatohet rregulli I gjysme rrethit pa ndeshje.

Diagram 1 Pozicioni I nje lojtare Brenda/jashte zones gjysme rrethore pa ndeshje.

ART. 35 GABIM I DY ANSHEM

Rregull:

Sa here qe kemi vendime kontraktore te gjyqtareve ose thyerje te rregullores ndodhin afersisht ne te njejten kohe dhe njeri prej denimeve eshte anullimi I koshit, ky denim mbizoteron dhe piket nuk do te jepen.

Shembull:

Ne nje akt gjuajtjeje kemi nje kontakt fizik midis gjuajtesit A4 dhe B4, topi hyn ne shportë. Gjyqtari prijes jep nje gabim sulmi ndaj A4 dhe keshtu koshi nuk do te numurohet. Gjyqtari ndjekes jep nje gabim mbrojtjeje ndaj B4 dhe keshtu koshi do te njihet.

Interpretim:

Ka ndodhur nje gabim I dyanshem dhe koshi nuk eshte I vlefshem. Loja do te rifillojë me rivenie nga ana e skuadres B ne zgjatim te vijes se gjuajtjes se lire. Skuadra A do te kete vetem aq kohe sa ka mbetur ne displayin e aparatit te 24 sekondave qe nga momenti qe ka ndodhur gabimi I dyanshem.

ART. 36 GABIMI JOSPORTIV

Rregull 1:

Gjate 2 minutave te fundit te periodës se katert dhe gjate 2 minutave te fundit te çdo periode shtese, topi eshte jashte vijave kufizuese per nje rivenie dhe eshte akoma ne duart e gjyqtarit ose eshte ne dispozicion te lojtarit qe do te beje rivenien. Gabimi I bere ne kete moment nga nje lojtar mbrojtës ne fushe ndaj nje lojtari te skuadres sulmuese, do te gjykohet si gabim josportiv.

Shembull 1:

Me 0:53 te lojes ne minuten e fundit te ndeshjes A4 ka topin ne duar ose eshte ne dispozicion te tij per te bere nje rivenie kur B5 shkakton nje gabim ne prekje.

Interpretim:

B5 nuk ben ndonje perpjekje per te luajtur topin dhe perfiton nje avantazh te pa drejte duke vonuar fillimin e kohes se lojes. Do te jepet nje gabim josportiv menjehere pa paralajmerim.

Shembull 2:

Me 0:53 te lojes ne minuten e fundit te ndeshjes lojtari A4 qe ben rivenien ka topin ne duar ose ne dispozicjon te tij kur A5 shkakton nje kontakt me B5 ne fushen e lojes I cili konsiderohet si gabim.

Interpretim:

A5 duke bere kete gabim nuk perfiton ndonje avantazh. Do te jepet nje gabim personal ndaj A5 me perjashtim kur eshte nje kontakt I rende qe do te jepet si gabim josportiv. Skuadres B do ti jepet topi per rivenie nga vendi me I afert me thyerjen e rregullave.

Rregull 2:

Ne minutat e fundit te nje ndeshjeje te ekuilibruar pasi topi ka lene duart e rivenesit ne loje, nje lojtar mbrojtës ne menyre qe te ndalojë ose te mos rifillojë ora e lojes shkakton nje kontakt me nje lojtar sulmues qe eshte gati per te marre topin ose qe ka marre topin ne fushen e lojes. Nje kontakt I tille do te jepet menjehere si gabim personal me perjashtim kur kemi nje kontakt te rende I cili do te jepet si gabim josportiv ose perjashtimi. Parimi I avantazh/disavantazhit nuk do te zbatohet.

Shembull 1:

Me 1:02 loje ne minuten e fundit te ndeshjes dhe me rezultatin A83-B80 topi eshte leshuar nga duart e lojtarit qe ben rivenien A4 kur B5 shkakton nje kontakt ne fushe ndaj A5 . Ndaj B5 eshte dhene nje gabim.

Interpretim: Ndaj B5 do te jepet menjehere nje gabim personal me perjashtim kur sipas gjykimit te gjyqtareve ashpersia e kontaktit te B5 kerkon nje gabim josportiv ose perjashtimi.

Shembull 2:

Me 1:02 loje ne minuten e fundit te ndeshjes dhe me rezultatin A83-B80 topi eshte leshuar nga duart e lojtarit qe ben rivenien A4 kur A5 shkakton nje kontakt ne fushe me B5. Ndaj A5 eshte dhene nje gabim.

Interpretim:

Duke bere kete gabim A5 nuk ka perfituar ndonje avantazh. Ndaj A5 menjehere do te jepet nje gabim personal me perjashtim kur kemi nje kontakt te rende. Skuadres B do ti jepet topi per rivenie ne loje nga vendi me I afert me thyerjen e rregullave.

Shembull 3:

Me 1:02 loje ne minute e fundit te ndeshjes dhe me rezultatin A83-B80 topi eshte leshuar nga duart e lojtarit qe ben rivenien A4 kur ne nje vend tjeter te fushes se lojes, B5 shkakton nje kontakt me A5. B5 I jepet nje gabim.

Interpretim:

B5 nuk ben ndonje perpjektje per te luajtur topin dhe fiton nje avantazh duke mos lejuar te filloje ora e lojes. Do te jepet nje gabim josportiv pa paralajmerim.

ART. 38 GABIMI TEKNIK

Rregull 1:

Kur nje lojtari i eshte bere nje verejtje zyrtare per nje veprim ose sjellje qe po te perseritet mund te denohet me gabim teknik, kjo verejtje do ti komunikohet gjithashtu trajnerit te skuadres dhe do te zbatohet per çdo antar te asaj skuadre per veprime te ngjashme ne pjesen e mbetur te ndeshjes. Kjo verejtje zyrtare do te behet vetem kur ora e ndeshjes eshte e ndaluar dhe topi eshte i ndalur.

Shembull:

Nje antari te skuadres A i eshte dhene nje verejtje per:

- (a) Nderhyrje gjate rivenies ne loje.
- (b) Sjelljes se tij.
- (c) Per çdo veprim tjeter qe po te perseritet mund te çojë ne nje gabim teknik.

Interpretim :

Verejtja do ti komunikohet gjithashtu trajnerit A dhe do te zbatohet per te gjithë antaret e skuadres A, per veprime te ngjashme, per pjesen e mbetur te ndeshjes.

Rregull 2:

Nese gjate nje intervali te lojes behet nje gabim teknik nga ana e nje antari te skuadres qe eshte regjistruar si lojtar-trainer. Ky gabim teknik do te numerohet si gabim i lojtarit dhe do te numerohet si gabim i skuadres ne perioden qe pason.

Shembull :

Lojtari-trainer A4 denohet me gabim teknik per:

- (a) Varje ne unaze gjate nxemjes perpara lojes ose ne intervalin e pjeses se pare.
- (b) Sjellje josportive gjate nje intervali te lojes.

Interpretim :

Ne te dy rastet, A4 do te denohet si lojtar. Gabimi do te numerohet si i tille qe te çon ne situaten e denimit te gabimeve te skuadres ne perioden qe pason dhe po ashtu ne nje prej pese gabimeve te A4 pas te cilave A4 perjashtohet nga loja.

Rregull 3 :

Gjate aktit te gjuajtjes nga loja te nje lojtari, kundershutareve nuk ju lejohet te hutojne kete lojtar me veprime si valvitje e duarve per te penguar fushen e pamjes se gjuajtesit, bertitje me ze te larte, perplasje e forte e kembeve ose perplasje e duarve afer gjuajtesit. Nje veprim i tille mund te çoje ne gabim teknik ne qofte se gjuajtjesi demtohet nga ky aksjon ose nje verejtje me paralajmerim ne qofte se gjuajtesi nuk demtohet.

Shembull :

A4 është në veprimin e gjuajtjes nga loja kur B4 perpiqet ta hutojë atë duke bertitur fort ose duke përplasur fort kembet në tokë. Gjuajtja përfundon :

- (a) Në kosh
- (b) Jashtë.

Interpretim :

- (a) B4 i jepet një vërejtje që i komunikohet dhe trajnerit B. Kjo vërejtje vlen për të gjithë lojtarët e skuadës B për veprime të ngjashme për të gjithë pjesën e mbetur të lojës.
- (b) B4 do të denohet me gabim teknik.

Rregull 4:

Një lojtar rihet në ndeshje pasi kishte plotësuar gabimin e pestë dhe pasi ishte njoftuar për këtë, ai nuk do të lejohet të vazhdojë me, pas zbulimit të një fakti të tillë ai do të denohet menjëherë, por pa demtuar kundërshtarët.

Shembull :

Pas plotësimit të gabimit të pestë, B4 njoftohet se nuk mund të vazhdojë të luajë me. Me vone, B4 hyn në lojë si zëvendësues. Hyrja e parregullt e B4 është zbuluar :

- (a) Për se topi të jetë në lojë për rifillimin e ndeshjes.
- (b) Pasi topi të jetë në lojë perseri dhe kur topi është në zotërim të skuadës A.
- (c) Pasi topi të jetë në lojë perseri dhe kur topi është në zotërim të skuadës B.
- (d) Pasi topi të jetë perseri i ndalur pas hyrjes në lojë të B4.

Interpretim :

- (a) B4 do të nxirret nga loja menjëherë. Trajneri B do të denohet me gabim teknik (regjistrohet 'B').
- (b) Ndeshja do të ndalohet menjëherë por pa demtuar skuadrën A. B4 do të nxirret nga ndeshja dhe trajneri B do të denohet me gabim teknik (regjistrohet 'B').
- (c) dhe (d) Ndeshja do të ndalohet menjëherë. B4 do të nxirret nga loja dhe trajneri B do të denohet me gabim teknik (regjistrohet 'B').

Rregull 5:

Nëse, pasi është njoftuar se duhet të dalë jashtë nga loja sepse ka plotësuar gabimin e pestë, një lojtar hyn në lojë perseri dhe shenon kosh, nën një gabim, ose ndaj tij është bërë një gabim nga kundërshtari për se të zbulohet pjesëmarrja e pa lejuar në ndeshje, koshi do të njihet dhe gabimi do të njihet si gabim i lojtarit.

Shembull :

Pasi ka plotësuar gabimin e pestë dhe është njoftuar se nuk mund të vazhdojë të luajë me, B4 hyn perseri si zëvendësues. Hyrja e pa rregullt e B4 është zbuluar .pasi:

- (a) B4 shenon një kosh.
- (b) B4 nën një gabim.
- (c) Ndaj B4 nën një gabim A4 (gabimi i pestë i skuadës).

Interpretim :

- (a) Koshi i shenuar nga B4 do te njihet.
 - (b) Gabimi i bere nga B4 do te konsiderohet si gabim lojtari.
 - (c) Dy gjuajtjet e lira te B4 do te gjuhen nga zevendesuesi i B4.
- Denohet per gabimin teknik trajneri B (i regjistruar 'B').

Rregull 6 :

Nese, pas plotesimit te gabimit te peste nje lojtar nuk eshte njoftuar se duhet te largohet nga ndeshja dhe ai mbetet (ose rihyn) ne ndeshje, ai duhet te largohet nga ndeshja sa me shpejt qe te jete e mundur pasi eshte zbuluar gabimi (por pa demtuar kundershhtarin). Ky veprim nuk do te denohet. Nese ky lojtar shenon nje kosh nga loja, ben nje gabim ose ndaj tij ka bere gabim kundershhtari, koshi do te njihet dhe gabimet do te njihen si gabime te lojtarit.

Shembull 1 :

A10 kerkon te zevendesoje A4. Me pas topi behet i ndalur si pasoje e nje gabimi te A4 dhe A10 hyn ne loje. Gjyqtaret harrojne te njoftojne A4 se gabimi i tij ishte gabimi i peste. Me vone A4 hyn ne loje si rezerve. Hyrja e parregullt e A4 zbulohet :

- (a) Pasi ka filluar punen ora e lojes dhe kur A4 eshte bere lojtar.
- (b) Pasi A4 ka shenuar nje kosh.
- (c) Pasi A4 ben nje gabim ndaj B4.
- (d) Pasi B4 ben nje gabim ndaj A4 qe nuk shenon.

Interpretim:

- (a) Ndeshja do te ndalohet, A4 do te nxiret nga loja menjehere dhe do te zevendesohet, por pa demtuar skuadren B. Nuk do te kete asnje denim per pjesmarjen e parregullt te A4 ne ndeshje.
- (b) Koshi i shenuar nga A4 do te njihet.
- (c) Gabimi i bere nga A4 do te konsiderohet si gabim i lojtarit dhe do te denohet si i tille.
- (d) Gabimi i B4 do te konsiderohet si gabim i bere ndaj nje lojtari. Zevendesuesi i A4 do te beje dy ose tre gjuajtje te lira.

Shembull 2 :

Dhjetë minuta para fillimit te ndeshjes, A4 denohet me gabim teknik. Para fillimit te ndeshjes B4 gjuan dy gjuajtje te lira. Ndeshja fillon me top te hedhur por B4 nuk eshte ne peseshen e pare te skuadres B.

Interpretim :

Njeri nga lojtaret e peseshes se pare duhet te beje gjuajtjet. Zevendesime nuk mund te behen para se te filloje punen ora e lojes.

Rregull 7 :

Ka lojtare qe per te perfituar me te padrejte ndonje gabim personal ose per te krijuar atmosfere jospportive te spektatoreve ndaj gjyqtarit, bien ne fushe. Kjo sjellje duhet konsideruar jospportive.

Shembull :

A4 është duke dribluar drejt koshit kur mbrojtësi B4 bie në fushe pa pasur ndonjë kontakt midis këtyre lojtarëve ose një kontakt fare të lehtë që nuk shkakton sjelljen teatrale të B4. Për një sjellje të tillë me parë është bërë një vërejtje për lojtaret e skuadës B nëpërmjet trajnerit të tyre.

Interpretim :

Një sjellje e tillë është jospportive dhe demton rrjedhjen normale të lojës. Duhet të jepet gabim teknik.

Rregull 8 :

Nga një rrotullim i jashtëzakonshëm i berrylave gjatë luftës në tabele ose në mbulimin nga afër mund të shkaktohet ndonjë demtim serioz. Nëse nga kjo situatë shkaktohet ndonjë kontakt do të jepet gabim personal. Nëse nga ky veprim nuk do të kemi kontakt fizik do të jepet gabim teknik.

Shembull :

A4 hyn në zotrim të topit në luftën në tabelë dhe bie në fushe. A4 menjëherë mbulohet nga afër nga B4. Pa prekur B4, A4 bën një rrotullim të jashtëzakonshëm të berrylave për të kërcënuar B4 ose për të krijuar hapsirë të mjaftueshme për këthese, pasim ose driblim.

Interpretim :

Veprimi i A4 nuk është në përputhje me shpirtin dhe qëllimin e rregullores. Ndaj A4 duhet dhënë gabim teknik.

ART. 39 RRAHJA

RREGULL :

Një skuadër i është dhënë rivenie në lojë sepse ajo skuadër kishte zotrimin e topit për shpërthimit të rrahjes, kur të fillojë loja kjo skuadër do të ketë vetëm aq kohë sa ka mbetur në aparatën e 24-sekondave.

Shembull :

Skuadra A kishte zotrimin e topit për 20 sekonda kur ndodh një situatë që mund të çonte në rrahje. Gjyqtaret përjashtojnë antaret e të dy skuadrave për lenien e kufirit të hapsirës së stolit të skuadës. Ndeshja fillon me rivenie për skuadrën A.

Interpretim :

Skuadës A që kontrollonte topin për situatën e rrahjes, do të jepet rivenie në lojë nga zgjatimi i vijës së mesit, përballë tavolines së gjyqtarëve me vetëm katër sekonda të mbetur në periodën e 24-sekondave.

ART. 42 SITUATA TË VEÇANTA

Rregull 1 :

Ne situata te veçanta kur nje numer denimesh duhen administruar ne te njejten periode te topit te ndalur, gjyqtaret duhet ti kushtojne nje vemendje te veçante radhes ne te cilen jane kryer shkeljet ose gabimet per te percaktuar se cilat denime duhen administruar dhe cilat duhen anuluar.

Shembull 1 :

A4 po ben nje gjuajtje me kercim. Ndersa topi eshte ne ajer, bie sinjali i 24-sekondave. Pas sinjalit, por ndersa A4 eshte akoma ne ajer, B4 ben nje gabim jospportiv ndaj A4 dhe :

- (a) Topi nuk prek unazen.
- (b) Topi prek unazen por nuk hyn ne shporte.
- (c) Topi hyn ne shporte.

Interpretim:

Ne te trija rastet gabimi jospportiv i B4 nuk mund te injorohet.

- (a) A4 eshte penguar nga B4 ne aktin e gjuajtjes. Shkelja e 24 sekondave per skuadren A nuk do te merret para sysh sepse ajo ka ndodhur pas gabimit jospportiv. A4 do ti jepen dy ose tre gjuajtje te lira pasuar nga rivenia ne loje nga skuadra A ne zgjatim te vijes se gjuajtjeve te lira perballe tavolines se gjyqtarise.
- (b) Nuk ka ndodhur shkelje e 24-sekondave ; A4 do ti jepen dy ose tre gjuajtje te lira, pasuar nga rivenie per skuadren A ne zgjatim te vijes se mesit, perballe tavolines.
- (c) A4 do ti jepen dy ose tre pike pasuar nga nje gjuajtje e lire per A4. Pastaj topi do ti jepet skuadres A per rivenie ne zgjatim te vijes se mesit, perballe tavolines.

Shembull 2:

A4 gjuan nga loja dhe B3 ben gabim ndaj tij, ndersa A eshte akoma ne aktin e gjuajtjes B4 ben gabim ndaj tij.

Interpretim:

Gabimi I B4 nuk do te merret parasysh me perjashtim nese ai eshte gabim jospportiv ose perjashtimi.

Rregull 2:

Nese gjate aktivitetit te gjuajtjes se lire ndodh nje gabim i dyanshem ose ndodhin gabime me denime te njejta, gabimet do te regjistroheshen por denimet nuk do te administrohen.

Shembull 1:

A4 po gjuan dy gjuajtje te lira. Pas gjuajtjes se pare :

- (a) A5 dhe B5 bejne nje gabim te dyanshem.
- (b) A5 dhe B5 bejne gabime teknike.

Interpretim :

Do ti regjistroheshen gabimet A5 dhe B5, me pas A4 do te gjuaje gjuajtjen e dyte dhe loja do te filloje normalisht si pas gjuajtjes se fundit ose te vetme te lire.

Shembull 2 :

A4 i jane dhene dy gjuajtje te lira. Te dy gjuajtjet perfundojne ne shporte. Para se topi te hyje perseri ne loje pas gjuajtjes se fundit te lire :

- (a) A5 dhe B5 kane bere nje gabim te dyanshem.
- (b) A5 dhe B5 kane bere gabime teknike.

Interpretim:

Ne te dy rastet (a) dhe (b), gabimet do ti ngarkohen lojtareve perkates, pas te cilit loja do te filloje me rivenie nga vija fundore ashtu si pas nje gjuajtje te vetme ose te fundit te lire qe perfundon me sukses.

Rregull 3 :

Ne rastin e nje gabimi te dyanshem dhe pas anullimit te denimeve te njejta te te dyja skuadrave nuk ka me denime per tu administruar, ndeshja do te filloje me rivenie nga skuadra qe zotronte topin ose qe kishte te drejten e topit para shkeljes se pare.

Ne rastin kur asnjera nga skuadrat nuk zotronte topin ose nuk kishte te drejten e topit para shkeljes se pare, kemi nje situatë te topit te hedhur. Ndeshja do te filloje me rivenie sipas zotimit alternativ.

Shembull :

Gjate intervalit te lojes ndermjet periodes se pare dhe te dyte lojtaret A5 dhe B5 denohen me gabime perjashtimi ose trajneri A dhe trajneri B denohen me gabime teknike.

Shigjeta e zotimit alternativ eshte drejtuar :

- (a) Per skuadren A.
- (b) Per skuadren B.

Interpretim :

(a) Ndeshja do te filloje me rivenie nga skuadra A ne zgjatim te vijes se mesit, perballe tavolines se gjyqtarise. Ne momentin qe topi prek nje lojtar ne fushe, shigjeta do te kthehet drejt skuadres B.

(b) E njejta procedure do te ndiqet, duke filluar me rivenie per skuadren B.

ART. 44 GABIME TE KORIGJUESHME

Rregull 1 :

Qe gabimi te jete i korigjueshem ai duhet te zbulohet nga gjyqtaret, gjyqtaret e tavolines ose vezhguesi para se topi te hyje ne loje, pas topit te pare te ndalur pasi ora e lojes te kete filluar punen pas gabimit. Kjo do te thote :

Ndodh gabimi	Te gjitha gabimet ndodhin gjate nje topi te ndalur.
Topi ne loje	Gabimi eshte i korigjueshem.
Fillon punen ora e lojes ose vazhdon te punoje	Gabimi eshte i korigjueshem
Topi i ndalur	Gabimi eshte i korigjueshem

Topi ne loje

Gabimi nuk eshte me i korigjueshem

Pas korigjimit te gabimit, ndeshja do te filloje dhe topi do ti jepet skuadres qe kishte te drejten e zoterimit te topit ne kohen kur ndeshja eshte nderprere per te korigjuar gabimin. Topi do ti jepet skuadres qe kishte te drejten e topit ne kohen kur ndeshja u ndalua per te bere korigjimin.

Shembull :

B4 ben gabim ndaj A4dhe ky eshte gabimi i dyte i skuadres B. Gjyqtari gabimisht i jep A4 dy gjuajtje te lira. Pas gjuajtjes se fundit te lire te sukseshme, ndeshja vazhdon dhe fillon punen ora e lojes. B5 merr topin, driblon dhe shenon.

Gabimi zbulohet :

- (a) Para se topi te jete ne dispozicion te lojtarit te skuadres A per rivenien nga vija fundore.
- (b) Pasi topi te jete ne dispozicion te lojtarit te skuadres A per rivenien nga vija fundore.

Interpretim :

Koshi i B5 do te njihet.

Ne (a), cdo gjuajtje e lire e bere do te anulohet. Gabimi eshte akoma i korigjueshem dhe skuadres A do ti jepet topi per rivenie nga vija fundore aty ku ndeshja eshte nderprere per te korigjuar gabimin.

Ne (b), gabimi nuk eshte me i korigjueshem dhe ndeshja do te vazhdoje.

Rregull 2:

Nese gabimi perben: nje lojtar tjeter (jo lojtari i duhur) ben gjuajtjen e lire (ose gjuajtjet e e lira), gjuajtja e lire (ose gjuajtjet e lira) qe behet si rezultat i gabimit do te anulohet. Topi do ti jepet kundershhtareve per ta vene ne loje ne zgjatim te vijes se gjuajtjes se lire. Nese ndeshja ka filluar, topi do ti jepet kundershhtareve per rivenie ne loje ne vendin me te afert me vendin ku ndeshja eshte nderprere, me perjashtim kur jane per tu administruar denime per shkelje te tjera. Ne qofte se gjyqtaret binden qe nje lojtar tjeter po ben gjuajtjet e lira, perpara se topi te jete ne dispozicion te lojtarit per gjuajtjen e pare ose te vetme te lire, ai duhet te nderrohet menjehere me lojtarin e duhur pa ndonje denim.

Shembull 1 :

B4 gabon ndaj A4 dhe ky eshte gabimi i gjashte i skuadres B. A4 i jepen 2 gjuajtje te lira. Ne vend te A4 gjuan A5 2 gjuajtjet e lira. Gabimi eshte zbuluar :

- (a) Perpara se topi te kete lene duart e A5 per gjuajtjen e pare te lire.
- (b) Pasi topi ka lene duart e A5 per gjuajtjene e pare te lire.
- (c) Pas gjuajtjes se dyte te lire qe perfundon ne shport.

Interpretim :

Ne (a), gabimi korigjohet menjehere dhe kerkohet qe A4 te gjuaje 2 gjuajtjet e lira pa ndonje denim per skuadren A.

Ne (b) dhe (c), 2 gjuajtjet e lira anulohen dhe loja do te filloje me rivenie per skuadren B ne zgjatim te vijes se gjuajtjes se lire.

E njejta procedure do te ndiqet nese gabimi i B4 eshte josportiv. Ne kete rast gjithashtu e drejta e zoterimit te topit si pjese e denimit do te anulohet dhe loja do te rifilloj me rivenie per skuadren B ne zgjatim te vijes se mesit.

Shembull 2 :

B4 ben gabim ndaj A4 qe ishte ne aktin e gjuajtjes. Ky pasohet nga nje gabim teknik i trajnerit B. Ne vend te A4 eshte A5 qe ben 4 gjuajtje te lira. Gabimi zbulohet para se topi te lere duart e skuadres A ne rivenien ne loje si pjese e denimit per gabimin teknik.

Interpretim :

2 gjuajtjet e lira te A5 qe duhet te ishin bere nga A4 do te anulohen dhe loja do te filloj me rivenie per skuadren A ne zgjatim te vijes se mesit perballe tavolines se gjyqtarise.

Rregull 3 :

Kur nje gabim eshte korigjuar, ndeshja do te filloje nga pika ku eshte nderprere per te korigjuar gabimin, me perjashtim kur korigjimi kerkon dhenien e gjuajtjeve te lira te merituarra dhe :

- (a) Nese nuk ka ndryshim te zoterimit te skuadres qe nga koha kur eshte bere gabimi, ndeshja do te filloje si pas nje gjuajtjeje normale te lire.
- (b) Nese nuk ka ndryshim te zoterimit te skuadres qe nga koha kur eshte bere gabimi dhe e njejta skuader shenon nje kosh, gabimi nuk do te merret parasysht dhe ndeshja do te filloje si pas nje koshi normal nga loja.

Shembull 1 :

B4 gabon ndaj A4 dhe ky eshte gabimi i peste i skuadres B. Gabimisht, A4 nuk i jepen 2 gjuajtje te lira por i jepet rivenie. A5 driblon topin brenda fushes kur B5 dergon topin jashte. Trajneri A kerkon pushim. Gjate pushimit, gjyqtaret kuptojne gabimin e korigjueshem ose atyre i terhiqet vemendja qe A4 duhet ti jepen 2 gjuajtje te lira.

Interpretim :

A4 do ti jepen 2 gjuajtje te lira dhe loja do te filloje ashtu si pas nje gjuajtjeje te lire normale.

Shembull 2 :

B4 gabon ndaj A4 dhe ky eshte gabimi i peste i skuadres B. Gabimisht, A4 nuk i jepen 2 gjuajtje te lira por i jepet rivenia. Pas rivenies ne loje, A5 driblon dhe gjuan nga loja por ai pengohet nga B4 dhe i jepen 2 gjuajtje te lira. Gjate pushimit zbulojne gabimin ose atyre i eshte terhequr vemendja se A4 duhet ti jepeshin 2 gjuajtje te lira.

Interpretim :

A4 do ti jepen 2 gjuajtje te lira pa lojtare te vendosur gjate trapezit. Pastaj A5 do te gjuaj 2 gjuajtje te lira dhe ndeshja do te filloj si pas nje gjuajtjeje te lire normale.

Shembull 3 :

B4 gabon ndaj A4 dhe ky eshte gabimi i peste i skuadres B. Gabimisht, A4 nuk i jepen 2 gjuajtje te lira por i jepet rivenia. Pas rivenies A5 gjuan dhe shenon 2 ose 3 pike. Para se topi te jete ne loje perseri, gjyqtaret zbulojne gabimin.

Interpretim :

Gabimi nuk do te perfillet dhe ndeshja do te vazhdoje ashtu si pas nje koshi normal nga loja.

ART.46 GJYQTARI I PARE : DETYRAT DHE TE DREJTAT**Rregull 1 :**

Gjyqtari pare eshte i autorizuar te percaktoj situatat kur duhet bere perdorimi i nje paisje teknike sipas vendimit te tij ose sipas kerkeses te nje trajneri, per te verifikuar nese gjuajtja e fundit ne mbarim te nje periode eshte bere gjate kohes se lojes dhe/ose gjuajtja e fundit do te numurohet 2 ose 3 pike . Ai eshte personi i vetem qe vendos kur duhet dhe kur nuk duhet perdorur nje paisje e tille.

Ne rastin e nje riperseritjeje te situates kjo do te behet nga gjyqtaret, vezhguesi, nese eshte prezent, dhe nga kronometrishi. Gjyqtari i pare do te japi vendimin perfundimtar.

Kerkesa per perdorimin e paisjes perseritese duhet te behet para fillimit te periodes tjetere ose para se gjyqtari i pare te kete nenshkruar protokollin.

Shembull 1 :

A4 gjuan me sukses nga loja kur bie sinjali per mbarimin e periodes ose ndeshjes. Trajneri B shpreh mendimin e tij se gjate gjuajtjes se fundit te A4topi eshte leshuar pas perfundimit te kohes se lojes dhe kerkon perdorimin e paisjes perseritese.

(a) Gjyqtaret jane krejtesisht te sigurt ne vendimin e tyre.

(b) Gjyqtaret kane dyshime ose mos perputhje nese gjuajtja eshte bere para renies se sinjalit per mbarimin e periodes ose ndeshjes.

Interpretim :

(a) Gjyqtari i pare refuzon kerkesen e trajnerit B.

(b) Gjyqtari i pare pranon kerkesen e trajnerit B.

Shikimi i perseritjes do te behet ne prani te gjyqtareve, vezhguesit, nese eshte prezent, dhe kronometrishi. Nese perseritja provon qarte se topi eshte leshuar pas perfundimit te kohes se lojes, te periodes ose ndeshjes, koshi do te anulohet. Nese perseritja provon qe topi ishte leshuar perpara perfundimit te kohes se lojes per perioden ose ndeshjen, do te konfirmohet rezultati i meparshem.

Shembull 2 :

Skuadra A eshte perpara me 2 pike. Sinjali per perfundimin e periodes ose perfundimin e ndeshjes bie kur eshte dhene nje gabim ndaj A4 dhe B4 i jane dhene 2 gjuajtje te lira. Te 2 gjuajtjet e lira perfundojne me sukses dhe rezultati barazohet. Perpara fillimit te periodes tjetere ose periodes shtese trajneri i skuadres A kerkon perdorimin e paisjes perseritese.

Interpretim :

Paisja teknike mund te perdoret vetem per te percaktuar nese gjuajtja e fundit eshte bere (jo dhenia e gabimit) para ose pas perfundimit te kohes se lojes te nje periode. Kerkesa e trajnerit A do te refuzohet.

Shembull 3 :

Skuadra A eshte perpara me 2 pike. Sinjali per perfundimin e periodes ose ndeshjes bie kur B4 gjuan nga loja dhe shenon, por gjyqtaret kane dhene vetem 2 pike dhe jo 3 pike. Perpara fillimit te periodes tjeter ose periodes shtese ose perpara se gjyqtari pare te firmose protokollin, trajneri i skuadres B kerkon perdorimin e paisjes perseritese.

Interpretim :

Paisja teknike mund te perdoret vetem per te verifikuar nese gjuajtja e fundit eshte bere brenda kohes se lojes dhe kjo gjuajtje eshte per 2 ose 3 pike. Kerkesa e trajnerit B do te pranohet.

Rregull 2:

Perpara ndeshjes gjyqtari i pare miraton paisjen teknike dhe informon te 2 trajneret per pranine e saj. Vetem paisja teknike e miratuar nga gjyqtari i pare mund te perdoret per riperseritjen e situates.

Shembull:

A4 gjuan nga loja ne kohen qe bie sinjali per mbarimin e periodes ose ndeshjes. Gjuajtja perfundon me sukses. Trajneri B kerkon perseritjen e situates sepse sipas mendimit te tij gjuajtja eshte bere pas perfundimit te kohes se ndeshjes. Ne fushe nuk ka paisje teknike te miratuar por menaxheri i skuadres B thote se ndeshja eshte filmuar nga nje video e skuadres nga nje pozicion i ngritur dhe paraqet tek gjyqtaret materjalin video per rishikim.

Interpretim :

Kerkesa e trajnerit B do te refuzohet.

ART 50 MBAJTESI I 24-SEKONDAVE : DETYRAT

Rregull :

Aparati i 24 sekondave do te shuhet pasi topi behet i ndalur dhe ora e lojes eshte ndalur kur ne te ishin me pak se 24 sekonda ose 14 sekonda te mbetur ne oren e lojes ne ate periode.

Shembull 1 :

Me 18 sekonda ne oren e lojes dhe 3 sekonda ne aparatit e 24 sekonda B1 ne pjesen e prapme shkelmon me qellim topin.

Interpretim :

Loja do te rifillojë me rivenie per skuadren A ne pjesen e perparme me 18 sekonda ne oren e lojes dhe 14 sekonda ne aparatit e 24 sekondave.

Shembull 2 :

Me 7 sekonda ne oren e lojes dhe 3 sekonda ne aparatit e 24 sekondave lojtari B1 ne pjesen e prapme te fushes shkelmon me qellim topin.

Interpretim :

Loja do te rifillojë me rivenie ne loje per skuadren A me 7 sekonda ne oren e lojes dhe aparati i 24 sekondave do te shuhet.

Perkthyer dhe pershtatur nga :

Jorgji SHUNDI